

# BPAL

## Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor Shesh shpim-kërkimi F53a, Blloku “F”



Republika e Shqipërisë

**Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor  
Shesh shpim-kërkimi F53a, Blloku F**

Autorizuar  
nga:



Përgatitur  
nga:



Prill 2016

## Përmbledhje

1	Hyrje.....	7
1.1	Objektivat.....	7
1.2	Kërkesat ligjore .....	7
1.2.1	Kuadri Ligjor Shqipëtar.....	8
	Për mbrojtjen e Mjedisit .....	9
	<i>I ndryshuar me:</i> .....	9
	- Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005.....	9
	- Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008.....	9
1.2.2	Standartet industriale .....	11
1.2.3	Kuadri Ligjor Ndërkombëtar .....	12
1.3	Metodologjia.....	14
1.3.1	Autorët.....	14
1.3.2	Konsultimi Publik.....	14
1.3.3	Mbledhja e informacionit .....	15
1.3.4	Profili i Kompanisë Zhvilluese .....	15
2	Përshkrimi i Projektit.....	16
2.1	Qëllimi i Projektit të Propozuar.....	16
2.2	Vendëndodhja e Projektit .....	18
2.3	Instalimet dhe Strukturat e Projektit .....	22
2.4	Ndërtimi dhe Procesi Teknologjik.....	27
2.5	Infrastruktura ekzistuese .....	33
2.6	Programi i ndërtimit.....	35
2.7	Strukturat që do të ndërtohen përfshijnë .....	35
2.8	Lënda e parë – Ndërtimi .....	36
2.9	Lidhjet me projektet ekzistuese.....	37
2.10	Alternativat e projektit.....	37
2.11	Lëndët e para – Funksionale .....	38
2.12	Aktivitetet lidhur me Projektin .....	38
2.13	Informacion mbi Liçensat dhe Lejet.....	39
3	Alternativat e Projektit.....	40
4	Përshkrimi i mjedisit.....	41
4.1	Kushtet fizike.....	41

4.1.1	Klima.....	41
4.1.2	Gjeomorfologjia .....	41
4.1.3	Gjeologjia .....	42
4.1.4	Sizmiologjia .....	45
4.1.5	Ujërat sipërfaqësore .....	46
4.1.6	Ujërat nëntokësore .....	46
<b>4.2</b>	<b>Biodiversiteti .....</b>	<b>47</b>
<b>4.3</b>	<b>Cilësia e mjedisit dhe ndikimet ekzistuese .....</b>	<b>48</b>
<b>5</b>	<b>Kushtet Sociale.....</b>	<b>50</b>
<b>5.1</b>	<b>Qëndrat e banuara.....</b>	<b>50</b>
<b>5.2</b>	<b>Marrëdhëniet midis komunitetit dhe Investitorëve .....</b>	<b>51</b>
<b>6</b>	<b>Ndikimet dhe masat zbutëse .....</b>	<b>54</b>
<b>6.1</b>	<b>Ndikimet në mjedis .....</b>	<b>55</b>
6.1.1	Ajri.....	57
6.1.2	Uji – Sipërfaqësor dhe Nëntokësor.....	57
6.1.3	Toka.....	57
6.1.4	Flora dhe Fauna.....	58
6.1.5	Sociale-ekonomike .....	58
6.1.6	Infrastruktura .....	58
6.1.7	Zhurmat.....	58
<b>6.2</b>	<b>Shkarkimet në mjedis.....</b>	<b>58</b>
6.3.	Potenciali i ndikimeve negative në mjedis.....	60
<b>6.4</b>	<b>Kohëzgjatja e ndikimeve negative .....</b>	<b>62</b>
<b>6.5</b>	<b>Rehabilitimi .....</b>	<b>62</b>
6.6.	Trashëgimia kulturore.....	63
6.7.	Aktivitete zbutëse .....	65
6.7.1.	Masat zbutëse.....	65
6.7.2.	Korporata e Menaxhimit Mjedisor.....	65
6.7.3.	Siguria dhe reagimi ndaj emergjencave.....	66
6.7.4.	Iniciativat mjdisore të korporatës.....	67
6.7.5.	Menaxhimi i mbetjeve .....	67
<b>7.</b>	<b>Ndërkufitare.....</b>	<b>68</b>
<b>8.</b>	<b>Ndikimet pozitive .....</b>	<b>68</b>
<b>9.</b>	<b>Masat zbutëse të propozuara .....</b>	<b>69</b>
<b>10.</b>	<b>Programet emonitorimit.....</b>	<b>69</b>

11. Plani i menaxhimit mjedisor .....	69
12. Shtojca.....	70
12.6. Përmbledhja jo – teknike .....	70
12.7. Çertifikata dhe Liçensa nga NLC.....	70

**Lista e tabelave**

Tabela 1: Grupi i punës .....	6
Tabela 2: Mbështetja ligjore .....	9
Tabela 3: Koventat Ndërkombëtare .....	12
Tabela 4: Përshkrimi i puseve prioritare .....	16
Tabela 5: Kohëzgjatja e projektit .....	35
Tabela 6: Vlerësimi i Alternativave të Projektit .....	37
Tabela 7: Lëndët e para për Shpimin dhe Veprimtaritë e Prodhimit .....	38
Tabela 8: Lloji i ndikimeve dhe kohëzgjatja .....	56
Tabela 9: Përmbledhja e ndikimeve .....	56

**Lista e figurave**

Figura 1: Struktura ligjore .....	8
Figura 2: Kufizimet dhe pamje e përgjithshme e Bllokut F.....	17
Figura 3: Gjeologjia e përgjithshme .....	18
Figura 4: Sheshi F53a dhe aksesit rrugor .....	20
Figura 5: Detaje e vendëndodhjes së sheshit F53a .....	21
Figura 6: Pjesët sipërfaqësore të pusit .....	25
Figura 7: Shëmbull i plan vendosjes të instalimeve të prodhimit në shesh .....	25
Figura 8: Shëmbull i ndërtimit të sheshit – Pamje profili .....	28
Figura 9: Shëmbull i kalimeve të shinave të hekurudhës .....	29
Figura 10: Shina jashtë funksionit dhe nënkallimet.....	29
Figura 11: Rampë provizore e automjeteve të tonazheve të rënda.....	30
Figura 12: Ura dhe lumi ekzistues.....	31
Figura 13: Projektimi i mbulesës së urës .....	32
Figura 14: Shëmbull i një ure të sigurt për kalimin e sondës.....	32
Figura 15: Example of Road Construction Design.....	36
Figura 16: Pamje e sheshit të zhvillimit .....	41
Figura 17: Harta gjeologjike e zonës në studim.....	42
Figura 18: Zonat me aktivitet sizmik në Shqipëri.....	46
Figura 19: Harta hidrologjike e zonës në studim .....	47
Figura 20: Degët e mjedisit .....	55
Figura 21: Zonat e mbrojtura rreth Fierit .....	64
Figura 22: Struktura e Menaxhimit të BPAL .....	66

Bankers Petroleum Albania Ltd.  
Raport Vlerësimi Mjedisor

Tabela 1: Grupi i punës

Grupi i Punës		Sonila Llupo Vilma Kola Jane Carss Dhurata Ndreko	Eksperte Mjedisori Eksperte Mjedisori Gjeologe Gjeologe
Përgatitur nga:		Sonila Llupo	Eksperte Mjedisori
Pajtuueshmëria ligjore		Realdo Mansaku	Akokat
Autorizuar nga :		Ing. Gentjan Filaj	Administratori i GR ALBANIA
Data e paraqitjes : Prill 2016			



## 1 Hyrje

Blloku F është një bllok i kërkimit të naftës dhe gazit, në afërsi të fushës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës që aktualisht është nën veprimtarinë e Bankers Petroleum Albania Ltd (BPAL). BPAL ka koncension për kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit në zonën e Bllokut F.

BPAL po aplikon për gjurmime në sheshin e shpimit F53a si pjesë e një programi kërkimi në Bllokun F. Kjo do të mundësojë BPAL të vlerësojë karakteristikat në rezervuarët mbajtëse të hidrokarbureve dhe nivelin e prodhimit sipas kërkesave të Marrëveshjes së Ndarjes së Prodhimit për Bllokun F.

GR Albania është kontraktuar nga BPAL për të realizuar një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis Paraprak icili kërkohet nga Neni 27/b në Ligjin Nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet mjedisore", lejet mjedisore të anuluar ose të pezulluara kur leje mbajtësi nuk përmbush kushtet e parashtruara në lejen mjedisore.

### 1.1 Objektivat

Qëllimi i këtij dokumenti është të përshkruajë dhe të sigurojë informacionin e nevojshëm në lidhje me kërkimin e hidrokarbureve në Bllokun F nga veprimtaria e BPAL.

Qëllimi i kësaj VNM paraprake është të japë informacionin e kërkuar nga rregulloret shqiptare, gjithashtu dhe të sigurojë që informacioni është i lidhur me informacionin në Aplikimin për Leje Mjedisore Tipi A.

Objektivi është të sigurojë informacionin e kërkuar siç parashikohet në Ligjin Nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet mjedisore".

Objektivi kryesor i raportit është të plotësojë sa më poshtë:

1. Të përshkruajë Menaxhimin Mjedisor të Kompanisë për këtë shesh.
2. Të sigurojë një përshkrim të projektit duke përfshirë edhe ndërtimin, veprimtarinë dhe ndryshimet e projektit dhe planet e rehabilitimit
3. Identifikimi i ndikimeve mjedisore
4. Listimi i masave zbutëse

### 1.2 Kërkesat ligjore

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

#### **Klasifikimi I Raportit të VNM-së**

Në bazë të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", kapitulli II, neni 7, "Projekte publike ose private të listuara në Shtojcat I dhe II, i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, para se autoriteti përgjegjës i jep licensën e duhur, për zhvillimin ose jo të projektit".

Klasifikimi i raportit të VNM është i bazuar në Shtojcat I dhe II të aktiviteteve të përcaktuara në anekset e ligjit të VNM:

Neni 8, projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) Projektet e listuara në Shtojcën II ,bashkangjitur me Ligjin e VNM

Neni 9,projekte që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis janë:

- a) Projektet e listuara në Shtojcën I

Studimi i projektit është subjekt i Shtojcës II, pika 2.5 për instalimet sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit dhe mineralet natyrore, si dhe argjila/rërë bituminozedhe do të ndjekë procedurën paraprake për të vlerësuar ndikimin në mjedis.

Struktura dhe përmbajtja e VNM është e bazuar në vendimin nr 13, datë 01.14.2013, "Për procedurën e VNM". Referuar vendimit Nr 13, kreu I, dokumentet për të aplikuar për vendimin e VNM preliminare janë:

- Përshkrimi i projektit
- Raporti i VNM paraprake
- Pranimi i pagesës së shërbimit

### 1.2.1 Kuadri Ligjor Shqipëtar

Hartimi i kuadrit ligjor shqiptar për mbrojtjen e mjedisit është përkrahur dhe nxitur nga direktivat evropiane për mbrojtjen e mjedisit.




Figura 1: Struktura ligjore

**Ligji nr. 10431, datë 10.03.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"**. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, për të parandaluar dhe për të zvogëluar rreziqet për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të sigurt dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës, për të mirën e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm dhe gjithashtu për të siguruar kushte për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Sipas nenit 3 të ligjit, objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë :



- a. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- b. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj;
- c. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peisazhit;
- d. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

**Parimet bazë të kreut II, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";**

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i marrjes së masave paraprake
- Parimi i parandalimit
- Parimi i "ndotësi paguan"
- Parimi i dëmit mjedisor riparim, shërim dhe rigjenerim
- Parimi i përgjegjësisë ligjore
- Parimi i mbrojtjes së nivelit të lartë
- Parimi i integritit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale
- Parimi i ndërgjegjësimit të publikut dhe pjesëmarrja në vendimmarrje mjedisore
- Parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore

*Tabela 2: Mbështetja ligjore*

<b>Ligjet bazë</b>	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011	Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis <i>I ndryshuar me;</i> - Ligjin nr. 12/2015
Ligji Nr. 10 448 datë 14.07.2011	Për Lejet e Mjedis <i>I ndryshuar me:</i> - Ligjin nr. 60/2014 datë 19.6.2014
Ligj nr.10 463 datë 22.9.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
Ligji Nr. 7746 datë. 28.07.1993	Për hidrokarburet <i>I ndryshuar me Ligjin nr. 19/2015 datë 12.3.2015</i>
Ligji Nr.8102 datë 28.3.1996	Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur <i>I ndryshuar me:</i> - Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005 - Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008
Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003	Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur
Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura <i>I ndryshuar me:</i> - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë <i>I ndryshuar me:</i> - Ligjin nr. 6/2015 datë 12.2.2015
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës
Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit” Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit
<b>Vendime</b>	
Nr. 686 datë 29.07.2015	“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, kreu I.
Nr. 419, datë 25.06.2014	Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet
Nr. 247 datë 30.4.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore
Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje
Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse
Nr.435 datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
Nr.824, datë 11.12.2003	Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme
Nr.114, datë 27.01.2009	Për Marrjen e masave emergjentë, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënproduktëve të tyre.

Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzim Nr.7938, datë 17.07.2014	Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së
Udhëzim Nr.6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre
Udhëzim Nr.6, datë 27.11.2007	Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis gazet dhe zhurmat.  <i>I ndryshuar me:</i>  - Udhëzimin Nr.12, datë 15.6.2010

### 1.2.2 Standartet industriale

Standartet dhe udhëzimet e mëposhtme janë të listuara si dhe janë të pranura gjerësisht për operacionet e eksplorimit dhe prodhimit në industrinë e naftës dhe gazit. Këto dokumente janë në dispozicion përmes [websites-ve](#) të organizatave. Dokumentet të cilat janë pranuar në të gjithë industrinë nga Shoqata Ndërkombëtare e naftës dhe gazit dhe Prodhuesit (OGP).

#### Udhëzues Menaxhimi HSE për të punuar sëbashku në një Kontratë Mjedisi (OGP, 2010)

Ky dokument rreshton pritjet minimale për Sistemet e Menaxhimit HSE dhe për kontrollin e zonave të caktuara të rrezikut, gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të operacioneve gjeofizike.

#### Rreziku mjedisor socio-shëndetësor dhe Procesi i Menaxhimit të Ndikimeve (OGP, 2007)

Ky raport është projektuar për të dhënë vlerë shtesë në projektet e naftës dhe gazit me cilësi të zgjeruara, duke siguruar qëndrueshmëri në shtrirjen e industrisë dhe duke integruar praktikën e mirë sociale, mjedisore dhe shëndetësore në sistemin e menaxhimit të HSE dhe projektit të vendimmarrjes në procesin e përgjithshëm.

#### Menaxhimi i Mjedisit në eksplorimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit (OGP/UNEP, 1997)

Bën një pasqyrë të çështjeve mjedisore, qasjet teknike dhe të menaxhimit në mënyrë që të arrihet një performancë e lartë mjedisore në eksplorimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit. Janë të përshkruara sistemet e menaxhimit dhe praktikave, teknologjive dhe procedurat që parandalojnë dhe minimizojnë ndikimin.

### Udhëzime për menaxhimin e mbeturinave (OGP, 1993)

Udhëzimet janë dhënë në zonën e planifikimit për menaxhimin e mbetjeve dhe metodat specifike për trajtimin e mbeturinave dhe kryesisht për mbeturinat që dalin nga shpimi dhe mbetjet e lëngshme.

Udhëzimet në Mbretërinë e Bashkuar për operacionet dhe eksplorimet tokësore.

IPIECA (Shoqata Ndërkombëtare e Industrisë së Naftës dhe Ruajtjes së Mjedisit)

### Industria e naftës dhe gazit: Veprojnë në mjedise të ndjeshme

Një shoqatë e industrisë së naftës ka bërë një botim me këto objektiva: demonstrimin se ndikimet minimale janë të arritshme në një gamë të ndryshme si për parametrat mjedisorë ashtu dhe për ato social, duke inkurajuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira të kompanisë dhe duke siguruar një bazë për diskutim me grupet jashtë industrisë me qëllim nxitjen e përmirësimeve të vazhdueshme në punën e industrisë.

### 1.2.3 Kuadri Ligjor Ndërkombëtar

Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që Shqipëria ka aderuar në lidhje me aktivitetet që shoqërojnë eksplorimin e naftës dhe gazit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 3: Konventat Ndërkombëtare*

Njohur si	Titulli i plote	Statusi	Permbledhje
Konventa ESPOO	Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nëkon ndërkufitar	Ratifikuar 25.02.1991	Kërkon që palët nënshkruese të kryejnë vlerësimin e ndikimit në mjedis të disa veprimtarive në një fazë të hershme të planifikimit dhe që shtetet të njoftojnë /konsultohen me njëri tjetrin për të gjitha projektet që cilat mendohet se do kenë të kenë ndikime negative.
Konventa e Bazelit	Konventa e Bazelit për kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve Të Rrezikshme	Ratifikuar Ligji nr. 8216	Kërkon zvogëlimin në minimum të transportit ndërkufitar dhe sasisë së mbetjeve të rrezikshme /jo të rrezikshme si dhe bën administrimin /asgjësimin e këtyre mbetjeve në mënyrën më të mirë për mjedisin.
CBD	Konventa për Diversitetin Biologjik. Ri de Janeiro 1992	Ratifikuar 10.11.1996	Angazhohet për ruajtjen e biodiversitetit, përdorim të pandërprerë të burimeve biologjike /ndarjen e barabartë të përfitimeve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjelbra.
Konventa e Bernës	Konventa për mbrojtjen e florës dhe faunës së egër /mjedisit natyror në Europë.	Ratifikuar nga Ligjinr.8294, 2.03.1998	Për garantimin e ruajtjes /mbrojtjes së florës/faunës së egër dhe mjedisit të tyre natyror, ritjen e bashkëpunimit midis palëve kontaktuese dhe nxjerjen e akteve regullatore për shfrytëzimin e specieve (dhe shtegtarëve).
GFCM	Marrëveshja për krijimin e Komisionit Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun.		Promovon zhvillimin ruajtjen dhe menaxhimin /përdorimin e përgjithshëm të burimeve detare në detin Mesdhe /detin e Zi

## Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor Shesh shpim-kërkimi F53a, Blloku F

UNFCC	Konventa kuadër e kombeve të bashkuara për ndryshimet klimatike	Ratifikuar 1995	Ka për qëllim reduktimin e emetiveve të gazeve për të luftuar ngrohjen globale.
ITES (Konventa Uashingtonit)	Konventa për tregtinë ndërkombëtare të Llojeve	25.09.2008	Garanton që tregtia ndërkombëtare e florës / Faunës së egër nuk përben kërcënim për ekzistencën e tyre.
CMS (Konventa e Bonit)	Konventa për Ruajtjen E llojeve shtegtare të Kafshëve të Egra.	Ligji nr. 8692 16.11.2000	Për ruajtjen e llojeve shtegtare të tokës, detit /zogjve shtegtare. Arritur nëpërmjet mbështetjes programi i OKB për Mjedisin.
Konventa e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s	Konventa e për mrojtjen e Kulturës Botërore/ Trashëgimisë Natyrore.	Ratifikuar 10. 07.1989	Ka për qëllim njohjen, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore në gjithë botën. Në Shqipëri janë përcaktuar dy qendra kulturore me vlerë universale të padiskutueshme.
Konventa e Aarhus-it	Konventa për të drejtën për Informim, pjesëmarrje në vendimarrjet dhe të Drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës për probleme të Mjedisit.	Ratifikuar Ligji nr.8672. 10. 07.1989	Garanton të drejtat e publikut për pjesëmarrje në procese vendimarrjeje të qeverisë për çështje që lidhen me mjedisin lokal, kombëtar, ndërkufitar si dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për sa më sipër. Kërkon më shumë bashkëpunim midis publikut dhe autoriteteve /enteve publike.
Konventa e Londres	Konventa e viti 1972 Për Parandalimin e Ndotjes së Mjedisit Detar Derdhjet e Mbetjeve dhe ëndet tjerë.		Ka qëllim parandalimin e endotjes së detit nga derdhjet mbeturinave dhe lëndëve të tjera të cilat janë përgjegjëse për krijimin e rreziqeve, dëmtimin e jetës së gjallë në dete, dëmtimin e pajisjeve, apo pengojnë përdorimin e tjerë të ligjshme të detit.
Konventa e Barcelonës	Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja	Ratifikuar Ligji nr. 8672. 26. 10.2000	Konventa Rajonale që ka qëllim parandalimin/ reduktimin e ndotjeve të shkaktuara nga anijet, aviounët, apo ndotje me prejardhje të ndryshme nga toka të cilat derdhen në Detin Mesdhe, psh. Nga derdhja e mbeturinave, shkarkime të ndryshme apo derdhja e lumenjve dhe poërenjve të ndohtur.
Konventa e Montrealit	Protokolli i për Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit.	Ratifikuar Ligji nr.8463.	Garanton mbrojtjen e shtresës së ozonit nëpërmjet zvogëlimit të shkallëzuar të substancave që shkaktojnë hollimin e saj.
ACCOBAMS	Marreveshje për ruajtjen e Cetaceveve në Detin e Zi, Detin Mesdhe dhe zonat afër Atlantikut	Eshtë futur në zbatim me Ligjin nr. 01/10/2001	Synon të reduktojë rrezikun ndaj Cetaceveve dhe të promovojë një bashkëpunim të ngushtë midis nënshkruesve me synin ruajtjen e specieve Cetaceve egzistuese në zone.
Konventa e Helsinkit 1992	Konventa për pasojat ndërkufitare nga aksidentet industriale	Ratifikuar Ligji Nr. 8216, 13/05/1997	Synon mbrojtjen e qenieve njerëzore dhe mjedistit kundrejt pasojave nga aksidentet industriale.
Protokolli i Kyotos	Protokolli i Kyotos i Kombeve të Bashkuara për	Ratifikuar 01/04/2005,	Një amendament për marreveshjen ndërkombëtare mbi ndryshimet klimaterike,

	kuadrin e konventes mbi Ndryshimet Klimaterike	Ligji Nr. 9334 (16/12/2004)	caktimi i limiteve detyruet te shkarkimeve per reduktimin e shkarkimit te gazeve sere per kombet nenshkruese.
MARPOL 73/78dhe aneksi IV	1973, Konventa per parandalimin e ndotjes nga anijet , i modiikuar nga Protokolli 1978 dhe amendamenti 2004 (aneksi IV)		Kerkon te parandaloje ndotjen nga nafta, kimikatet dhe substancat e rrezikshme ne forme te paketuuar, ujerat e zeza dhe mbetjet nga anijet. Aneksi IV: anijet do te pajisen me impjant trajtimi te ujrave te zeza ose sistem grimcimi dhe dezinfektimi ose depozit per grumbullimin e ujrave te zeza.
Konventa Ramsar	1971 Konventa mbi Ligatinat me Rendesi Nderkombetare sidomos Habitati i Shpendeve Ujore	Ratifikuar 29/03/1996	Synon te ndaloje humbjet boterore te ligatinave dhe promovojte konservimin e ligatinave nepermjet perdorimin dhe menaxhimin e duhur.
UNCLOS (ose ligji I Detit)	Konventa e Kombeve te Bashkuara per Ligjin e Detit (1982)	Hyre ne fuqi 23/06/2003	Legjislacioni per oqeanet dhe detet boterore duke rregulluar perdorimin e oqeaneve dhe burimeve te tyre.

### 1.3 Metodologjia

#### 1.3.1 Autorët

VNM Paraprake për kërkimin e naftës u përgatit nga “GR Albania” sipas marrëveshjes kontraktuale me kompaninë "Bankers Petroleum Albania Ltd.".

GR Albania ofron konsulencën e saj në fushën mjedisore që nga viti 2009 dhe është e licencuar për aktivitetin me ekspertizë për impaktet në mjedis. Kjo kompani është e akredituar si një laborator testimi për cilësinë e ajrit, ujit dhe nivelit të zhurmave.

Kjo kompani ka ndihmuar industrinë dhe vendimmarrësit në çdo nivel që të arrijnë objektivat mjedisore duke zhvilluar studime strategjike, menaxhim mjedisi, procedurat për pajisen me leje mjedisore, vlerësimi i ndikimeve në mjedis dhe autidim mjedisor, menaxhim risku, vlerësim i tokës dhe ujërave nëntokësorë, menaxhim i mbetjeve të ngurta, monitorim i cilësisë së ajrit, monitorim i cilësisë së ujit, emetimi i zhurmave dhe indikatorët mjedisorë.

Autorët e këtij raporti VNM:

**Gentjan Filaj** – Inxhinier gjeofizik

**Jane Carss** – Gjeologe

**Vilma Kola** – Inxhiniere mjedisi

**Realdo Mansaku** – Jurist

**Sonila Llupo** - Biologe

**Stela Dhima** – Studjuese e çështjeve sociale

#### 1.3.2 Konsultimi Publik

Konsultimi publik është realizuar disa herë për projekte të ndryshme në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës për llogari të BPAL. Konsultimi publik do të ndiqet edhe në fshatrat përkatës që janë të ndikuara nga aktiviteti i Bllokut F.

### 1.3.3 Mbledhja e informacionit

Ky Vlerësim i Ndikimit në Mjedis Paraprak është plotësuar për Bllokun F sheshi 53a. Ky shesh do të përdoret për për të vërtetuar mundësinë e gjetjes së hidrokarbureve që mund të shfrytëzohen nga BPAL.

Informacioni i mbledhur për këtë VNM jep informacion të bazuar në nevojat imediate për tesimin dhe prodhimin e hidrokarbureve. Ky informacion teknik për të plotësuar VNM Paraprake u sigurua nga inxhinierët e BPAL. Informacioni tjetër ose është referuar nga VNM Paraprake ose është marrë nga vizitat në terren dhe informacionet rajonale.

### 1.3.4 Profili i Kompanisë Zhvilluese

Bankers Petroleum Albania Ltd. (BPAL) është pjesë e Bankers Petroleum Ltd., e cila është një kompani Kanadeze prodhuese e naftës që po investon në Shqipëri që nga viti 2004. BPAL është zhvilluar për Shqipërinë duke vënë në aktivitet burimin më të madh natyror të vendit. Deri më sot BPAL ka investuar më shumë se 1.8 miliard dollarë (2004-2015) në Shqipëri, duke dyfishuar rezervat e naftës dhe ka rritur maksimumin e prodhimit në mbi 20000 fuçi naftë në ditë. BPAL është zgjeruar dhe është shndërruar në investitorin më të madh të huaj, taksapaguesi më i madh dhe një nga punësuesit më të mëdhenj në Shqipëri.

BPAL është angazhuar të ngrejë vlerat e grupeve të interesit përmes zhvillimit të përgjegjshëm të këtij asseti me rëndësi botërore në Shqipëri. BPAL ka krijuar një ekip teknik me eksperiencë që është duke zbatuar teknika perëndimore Kanadeze të nxjerrjes së naftës në Patos-Marinzë, fusha më e madhe naftëmbajtëse në tokë në Evropë.

BPAL ka shpuar 536 puse të reja në 2004-2015. Kompania punëson direkt 500 njerëz dhe 1200 të tjerë janë të punësuar indirekt nëpërmjet kompanive të shërbimit, ndërkombëtare ose lokale. BPAL ka investuar mbi 10.5 milion në pastrimin e mjedisit në më shumë se 600 sheshe. Po ashtu, edhe 6.2 milion janë investuar për marrëdhënie me komunitetin.

BPAL vepron në dy zona: Patos-Marina (PM) dhe Bllok F. Prodhimi kryesor dhe shërbimet janë të lokalizuara në PM, e cila ka qenë në prodhim për më shumë se 85 vjet. Blloku F është një zonë në kërkim. Sukses i BPAL bazohet në ekzekutimin e programeve primare të shpimit, duke zgjeruar kufijtë e prodhimit dhe duke aplikuar teknika të përmirësara të grumbullimit.

## 2 Përshkrimi i Projektit

Në këtë seksion jepen detaje rreth vendëndodhjes së projektit, qëndrave të banuara në afërsi, planimetrisë së sheshit gjatë shpimit dhe fazës së prodhimit, materialeve ndihmëse të nevojshme për zbatimin e projektit të propozuar dhe alternativave që janë marrë në konsideratë gjatë fazës së projektimit të këtij projekti.

Puset e planifikuar në Bllokun F do të kenë si qëllim zbulimin e zonës naftëmbajtëse në shtresat ranore messiniane të Bubullimës. Nëse zbulohet naftë do të realizohen shumë punime testimipër të kuptuar më mirë përmbajtjen e lëngët, karakteristikat e rezervuarit dhe nivelet e prodhimit të Bllokut F sipas kërkesave të Marveshjes së Ndarjes së Prodhimit.


### 2.1 Qëllimi i Projektit të Propozuar

Në programin e shpimit të Bllokut F në 2016 është edhe një program kërkimi. Një pus do të shpohet në sheshin F53a siç përshkruhet në këtë document. Një shesh I dytë, AT75a është pjesë e programit të shpimit të 2016. Njëri nga pusët është vërtetuar që të jetë ekonomik dhe më pas mund të shpohen pusët e tjera dhe mund të zbatohet skema e Nxjerrjes së Përmirësuar të Naftës (Enhanced Oil Recovery, EOR).

Tabela 4: Përshkrimi i puseve prioritare

Vendndodhja	Përshkrim	Prioriteti
Sheshi F53a	Qëllimi primar është seksioni sipër të mesmes Messinian (posht bazës ranore të Marinzës). Qëllimi sekondar është Bubullima. Shesh i një pusi të vetëm.	1
Sheshi AT76a	Shesh me shumë puse. Qëllimi primar është seksioni sipër të mesmes Messinian. Qëllimi (qëllimet) sekondar është të çarat e thella në strukturën e Bubullimës.	2





*Figura 2: Kufizimet dhe pamje e përgjithshme e Bllokut F*




Figura 3: Gjeologjia e përgjithshme

Pusi që ndodhet në sheshin F53a është vlerësuar që të arrijë 3100m në thellësinë e matur (md). Pusi do të shpohet në vertikal dhe zona e synuar do të jetë e ndryshme nga vendodhja sipërfaqësore.

Njëri nga pusët është vlerësuar të jetë ekonomik, pajisjet e infrastrukturës së prodhimit do të mbështesin prodhimin dhe trajtimin e naftës dhe më pas transportin në Facilitetin Qëndror të Trajtimit (Central Treatment Facility (CTF), për më shumë trajtim.

## 2.2 Vendëndodhja e Projektit

Vendëndodhja e sheshit F53a është e lokalizuar në afërsi të fshatit Lalari. Fshati i Lalarit ndodhet 20 km larg në jugperëndim të Impjantit Qëndror të Trajtimit dhe 10 km në jug të qytetit të Fierit.

Fshati Lalari ka një komunitet të vendosur përgjatë lumit. Banorët kanë parcela bujqësore dhe merren me blektori. Zonat përreth janë kryesisht toka bujqësore dhe gjithashtu nuk ka banesa në afërsi të vendodhjes së propozuar.

Pjesa e rrugës jashtë rrugës kryesore është afërsisht 5050 m e gjatë, e cila është me kthesa dhe në terren malor. Mundësia për të shkuar drejt zonës është nëpërmjet rrugës kombëtare dhe më pas nëpërmjet rrugës dytësore e cila nuk është në kushte të mira, e cila do të rikonstruohet si pjesë e projektit. Për të

## Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor Shesh shpim-kërkimi F53a, Blloku F

mundësuar shkuarjen e automjeteve të tonazheve të rënda drejt sheshit te pusit duhet te kalohet linja e vjetër hekurudhore dhe lumi i Gjanicës. Linjat elektrike dhe linjat e telekomunikacionit do të duhet të vlerësohen përgjatë rrugës së transportit dhe të pjesëve të cilat duhet të rikostruktohen. Ky vlerësim do të jetë pjesë e e ndërtimit e BPAL.

Rezervuari i Kreshpanit ndodhet 0.9 km larg nga drejtimi jugor i kësaj vendodhje.

Përcaktimi i sheshit të pusit, u bazua në informacionet teknike dhe mjedisore të hartuara nga BPAL dhe që sigurojnë masat dhe potencialin e ndikimeve negative mjedisore dhe ato sociale.







Figura 4: Sheshi F53a dhe aksesi rrugor





Coordinate System: Pulkovo 1942 GK Zone 4  
 Projection: Gauss Kruger  
 Datum: Pulkovo 1942  
 False Easting: 4,500,000.0000  
 False Northing: 0.0000  
 Central Meridian: 21.0000  
 Scale Factor: 1.0000  
 Latitude Of Origin: 0.0000  
 Units: Meter

Coordinate System: Pulkovo 1942 GK Zone 4  
 Projection: Gauss Kruger  
 Datum: Pulkovo 1942  
 False Easting: 4,500,000.0000  
 False Northing: 0.0000  
 Central Meridian: 21.0000  
 Scale Factor: 1.0000  
 Latitude Of Origin: 0.0000  
 Units: Meter

Figura 5: Detaje e vendëndodhjes së sheshit F53a

Vija e kuqe përcakton kufirin e zonës së propozuar dhe vija e pa ndërpreë përcakton zonën për të cilën hartohet Vlerësimi Mjedisor i Ndikimit dhe aplikim për leje. Ndryshimi ndërmjet dy zonave është se në zonën e vogël do të zhvillohen punime për një pus shpimi të programuar dhe nëse do të ketë sukses zona do të zhvillohet duke shtuar numrin e puseve dhe të instalimeve për prodhim.

Vendëndodhja ndodhet shumë larg nga toka në pronësi dhe nuk vlerësohet si tokë bujqësore. Do të përdoret një zonë ekzistuese djerë. Infrastruktura rrugore është e gjatë dhe më kthesa. Kres 6 është një pus ekzistues i cili ndodhet afërsisht 45 m në pjesën verilindore të zonës së propozuar.

### 2.3 Instalimet dhe Strukturat e Projektit

Në sheshin e përcaktuar do të shpohet një pus i vetëm por me opsionin e shtimit të puseve dhe të instalimeve prodhuese në të ardhmen duke u bazuar në nxjerrjet e pusit të parë. Ky pus do të shpohet vertikalisht duke përdorur teknologjinë e njohur të puseve për të arritur qëllimin e ndërfutjes në formacionet nëntokësore.

Më poshtë paraqitet përshkrimi e fazve kryesore të shpimit dhe të prodhimit të puseve.

#### 1. Sheshi dhe aksesimi rrugor

- Sheshi i ndërtimit dhe infrastruktura rrugore, sigurojnë lëvizjen e automjeteve për gjatë gjithë gjatësisë së saj dhe të automjeteve të tipit të rëndë. Është e nevojshme përmisimi i pikave të kontrollit për të siguruar sigurinë e punëtorëve dhe të atij publik. Cdo rrugë e re që do të ndërtohet në këtë projekt do të jenë në fuksion edhe të komunitetit të zonës pas përfundimit të tyre.
- Energjia elektrike do të sigurohet nga gjeneratorët ose pas lidhjes më rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektike.
- Telekomunikacioni mund të instalohet ose të përmisohet nëse është e nevojshme.
- Rrjeti hekurudhor i zonës duhet të përmisohet si një kërkesë për një transport sa më të sigurt.
- Plani i kalimit të lumit përfshin opsionet e mëposhtme: 1) Kalimi i lumit në rastet kur niveli i ujit gjatë sezonit të thatë; 2) testimi i urës ekzistuese për kapacitetin e ngarkesës për rikonstruksionin i saj nëse është e nevojshme; 3) ndërimi i një ure të përkohshme në lumen e Gjanicës. Shpimi
- Përfundimi i shpimit, regullimi i grykës së pusit dhe sigurimi i tij.
- Përfundimi i testimit të pusit për të siguruar që inxhinierët dhe gjeologët kanë informacionin e nevojshëm.

#### 2. Shpimi

- Plotësoni shpimin, strukturën nëntokësore dhe sigurimin e një pusi
- Testimi i plotë i pusit për të siguruar që inxhinierët dhe gjeologët kanë informacionin e nevojshëm.

#### 3. Prodhimi

- Lloji dhe numri i instalimeve do të përcaktohet bazuar nga informacioni i pusit.
- Në instalimet e operimit mund të përfshihen pompat, depozitat, fakel, pompat për kimikate dhe tubacionet e rrjedhjes, instalimet e injektimit kimik, shpërndarësit dhe instalime të tjera standarte në fazën operale.

#### 4. Mbyllja

- Mbyllaj e pusit bëhet sipas praktikave të industrisë dhe ligjeve.
- Rehabilitimit i sheshit.
- Përmirësimi i sheshit dhe aksesit rrugor sipas standarteve të miratuara.

#### **Faza 1 – Ndërtimi i sheshit dhe aksesit i infrastrukturës rrugore**

Rruga e qasjes do të ndërtohet duke përdorur rrugët ekzistuese aty ku është e mundur, duke përmirësuar seksionet e rrugës që duhen përmirësuar dhe për të zgjeruar rrugën në mënyrë që të bëhet pa vështirësi kthimi i mjeteve të gjata e të gjera, si dhe ndërtimet e reja aty ku është e nevojshme. Rruga nga Patos-Marinëz deri në këtë shesh do të jetë nga autostrada Visoka-Patos.

Në aksesin rrugor do të merret parasysh edhe kalimi i linjës hekurudhore duke u bazuar në: 1) duke përdorur nënkalimet e linjës hekurudhore ose 2) duke ndërtuar një kalim sipërfaqësor i përkohshëm apo i përhershëm në linjën hekurudhore. Është vlerësuar që mundësia e kalimit sipërfaqësor të linjës hekurudhore është e mundur për arsye se linja hekurudhore është jashtë funksionit. Nëse zgjidhet kalimi nënhekurudhor, duhet të ndërtohet një tunel duke gërmuar poshtë linjës hekurudhore duke siguruar kalimin e automjeteve të tonazheve të rënda.

Infrastruktura rrugore e cila do të mundësojë kalimin e lumit duhet të: 1) kalimi i lumit në vëndet me nivel të ulët të ujit gjatë sezonit të thatë, ose 2) testimi dhe rikostruksioni i urës ekzistuese për peshat e rënda ose 3) ndërtimi i një ure provizore në lumin Gjanicë që do të lejojë kalimin e automjetet e tonazheve të rënda.

Përmirësimet dhe ndryshimet në rrugë, duke përfshirë tunele hekurudhor dhe ura mund të ndërtohen, ato do të kalohen bashkisë pas ndërtimit pasi kjo do të zgjasë sistemin rrugor publik dhe nuk mund të mbahet si një rrugë private. Ngritja ose zhvendosja e energjisë dhe e linjave të telekomunikacionit në një lartësi prej 5.5 m mund të jetë e nevojshme nëse këto linja janë të vendosura shumë ulët për të lejuar një kalim të sigurt të automjeteve.

Ndërtimi dhe përmirësimet në rrugë do të përfshijë heqjen e materialit të papërshtatshme rrugore me buldozer duke praktikuar mbushjen, compaction dhe nivelim. Nëse ka material të mjaftueshme në vend, atëherë materiali konsiderohet i përshtatshëm për përdorim si industriale/komerciale për mbushje. Kjo mund të përfshijë edhe prerjet e thata të shpimit nga facilitetit i baltës dhe i tharjes së prerjeve të shpimit e BPAL e prerje tharjes objektit, si dhe nga sasi të depozituar ekzistuese të tokës. Pas ngjeshjes, nota të ndryshme të zhavorrit gelqeror do të dorëzohet me kamionë. Zhavorr do të përhapet duke përdorur buldozer, makinë niveluese dhe ngjeshës.

Në zonën e propozuar në të cilën do të zhvillohen punime ndërtimore do të zbatohen metoda të cilat shkaktojnë ndikime minimale dhe me qëllim zvogëlimin e ndikimeve kumulative në tokë, bimësi, në peisazhet natyrore dhe tek aktorët përreth.

Transportimi i sondës dhe pajisjet e tjera do të realizohet afërsisht nga 30 kamionë. Këto ngarkesa do të transportohen nga operatorët me përvojën e duhur. Seksionet e rrugës, duke përfshirë edhe qoshet, zonat e trafikut të lartë, të tunelit hekurudhor dhe kalimi i urës, nëse do të përdoren, do të monitorohen dhe do të kontrollohen nga persona me flamur. Kjo do të mundësojë transportin e sigurt të pajisjeve.

Lëvizja e automjeteve do të përcaktohet në atë mënyrë që të mos shkaktojë probleme në trafik apo të ndalojë qarkullimin e automjeteve.

## **Faza 2- Shpimi**

Pus i propozuar do të shpohet në përputhje me teknikat e puseve që zbaton BPAL dhe programin. Ka shumë faktorë në shpimin e pusit sic është përcaktimi i përmasve të sondës që nevojitet të materialeve të kërkua (balta e shpimit, uji, tubat e shpimit dhe tubat metalik sipërfaqësorë), të cilat sigurojnë që aktiviteti i shpimit do të jetë komplet i sigurt.

Gjithashtu i rëndësishëm është edhe menaxhimi i mbetjeve të përftuara. BPAL ka ndërtuar shumë instalime, në mënyrë që të menaxhojë dhe të trajtojë mbetjet dhe materialeve të ndryshme si Sheshi i Depozitimit Kallmi, fasiliteti i mbetjeve të ngurta, fasiliteti i përpunimit të baltës nga shpimi, fasiliteti i trajtimit të llumit dhe Gropat Ekologjike. Në vijim, më poshtë është një përmbledhje e komponentëve të ndryshëm.

### Balta e Shpimit

Programi i shpimit të pusit bazohet në përdorimin e ujit për shpim e tij. Një tjetër proces shpimi që do të realizohet është përdorimi i ujit bazuar në përdorimin e xhel – kem.

### Gryka e pusit dhe tubat e shpimit

Pusi do të jetë i izoluar në mënyrë të tillë, që të izolohet hidrokarburet me vendëndodhjen e formacioneve të ujit dhe në këtë mënyrë nuk do të ketë komunikim ndërmjet formacioneve. Programi do të jetë i njëjtë me puset e prodhimit, të cilët ndjekin praktikat e mira internacionale të shpimit. Më shumë informacione të detajuara do të paraqiten së bashku, si në raportimin dhe në aplikimin e PSA (Petroleum Sharring Agreement) dhe në detajet finale të programit të testimit të shpimit.

### Menaxhimi i mbetjeve

Mbetjet e ngurta dhe të lëngshme do të gjenerohen nga shpimi dhe në fazën e testimit. Si mbetje klasifikohen: balta e shpimit, prerjet e shpimit, skrap celiku, mbetje naftë, rërë e prodhuar, llum i mbetur nga operatorët e mëparshëm, toka e kontaminuara, ujrat urbane dhe teknologjike, mbetje e përgjithshme urbane, mbetje të tjera të industriale të rrezikshme apo të parrezikshme. Fasilitetet e mbetjeve të BPAL që u lart përmendën, do të përdoren për menaxhimin e mbetjeve.

Të gjitha aktivitetet në lidhje me shpimin sic është hapja e pusit, testimi i pusit dhe mbyllja e pusit dhe pajisjet e prodhimit duhen gjithashtu të përmenden. Testimi mund të zgjasë 30 dite ose më shumë, e cila është në vartësi të prodhimit dhe sipas treguesit të prodhimit të hidrokarbureve. Për reduktimin e ventilimit dhe djegien e përkohshme në oxhaqe mund të vlerësohet mundësia në lidhje me prodhimin e gazit. Matjet e testeve se bashku me informacionet gjeofizike, gjeologjike, shpimit dhe të prodhimit ndihmojnë në përcaktimin e karakteristikave të rezervuarit, në vetitë e shkëmbit dhe të naftës të cilat do të ndihmojnë në vlerësimin e sasisë komerciale në këtë pus.

Mbetjet mund të riciklohen ose të grumbullohen nga nënkontraktorët në raste kur është e mundur. Materialet do të transportohen duke përdorur një dokumentacion të përshtatshëm dhe do të trajtohen dhe do të depozitohen në bazë të licensës për menaxhimin e mbetjeve dhe lejeve mjedisore që mund ta disponojë një kompani kontraktore.



**Faze 3-Prodhimi**

Pusi do të vlerësohet gjatë shpimit ose në konkluzionet përfundimtare të tij. Duke u bazuar në një sërë vlerësimesh të përfundimit dhe të zhvillimit të pusit nga inxhinierët dhe nga operatorët e fushës, sigurohet që pusi është produktiv dhe eficient në prodhimin e naftës.

Instalimet e nëndheshme të pompimit të pusit mund të instalohen si shtesë e instalimeve sipërfaqësore. Në instalimet sipërfaqësore mund të përfshihen jo vetëm, koka e pusit, njesia e energjisë (naftë, propan dhe/ose energji elektrike), depozitat e naftës dhe linja e tubacionit.



Figura 6: Pjesët sipërfaqësore të pusit



Figura 7: Shëmbull i plan vendosjes të instalimeve të prodhimit në shesh

Instalimet sipërfaqësore të prodhimit që mund të instalohen në shesh:

- Depozitat e prodhimit
- Diluent tanks
- Depozitat e ujit dhe pompat
- Flare knockout drum (FKOD)
- Gaz/naftë enët nënpresion
- Koka e pusit
- Paletat rrëshqitëse të polimerit me pajisjet e nevojshme të përzierjes dhe injektimit të polimerit
- Sistemi i tubacionit
- Pjesët sipërfaqësore të pusit
- Gjeneratorët
- Instalimi i djegies së gazit natyror
- Instalimi i menaxhimit të mbetjeve (referohu seksionit përkatës)
- Vendodhja e depozitës së kimikateve
- Kapanonet/depot
- Linja e enrgjisë
- Depozitat e rërës
- Enët e presionit / ndarës
- VRU
- Paletat lëvizëse hidraulike
- Depozitat e naftës
- Shkëmbyes nxehtësie

Puset fllimisht do të testohen dhe do të vlerësohen duke u bazuar në kapacitetin e prodhimit të naftës para se të vihen në prodhim. Sasitë e lëgta të prodhuara do të jenë naftë, ujë dhe një përzierje gazi e cila duhet të ndahet para se të shitet. Pajisjet e montuara në shesh do të realizojnë dhe do të sigurojnë ndarjen fillestare në tri faza- naftë, ujë dhe gaz natyror. Nafta do të depozitohet në depozita e cila do të transportohet me kamion ose me linjën e tubacioneve drejt pikave të licensuar për shitje. Uji i përftuar do të ri-injektohet për tu shkarkuar në puset e përcaktura për shkarkim. Gazi natyror do të mblidhet dhe duke u bazuar në volumin e tij do të shitet ose do të përdoret si burim energjie për pajisjet në shesh, ose do të digjet.

Disa pajisje ndoshta do të instalohen brenda zonës së projektit në një bazë të përkohshme me zhavorr, ose direkt në tokë të sheshuar. Vendosja e pajisjeve direkt në tokë të rrafshuar, zvogëlon nivelin e ndërtimeve mbi tokë duke e mundur atë që të kthehet në tokë bujqësore sa më shpejt pai ajo nuk është më e nevojshme. Infrastruktura rrugore është projektuar dhe do të ndërtohet në varësi të kapacitetit të lëvizjës së automjeteve të tonazheve të rënda, duke përjashtuar në këtë mënyrë ndërtimin e rrugëve të reja.

Planimetria e sheshit dhe pajisjet e kërkua nuk do të konfirmohen deri në momentin e shpimit të pusit të nivelit të prodhimit, të metodave optimale të prodhimit që do të zbatohen në këtë burim.

#### Faza 4 –Mbyllja dhe rehabilitimi

Mbyllja e pusit do të realizohet pasi të jetë vendosur që nuk do të jetë më ekonomik për më gjatë për nxjerrjen e hidrokarbureve ose që nuk mund të përdoret për qëllime injektimi. Ky është një vendim merret nga inxhinierët me eksperiencë.

Mbyllja e pusit do të duhet të ndjekë proceduarat e praktikueshme në Industrinë Ndërkombëtare për të siguruar që shpimi është siguruar dhe se nuk ka asnjë mundësi për komunikim ndërmjet shtresave. Mbyllja tipike e një pusi përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

- Largimi I pajisjeve që përdoren në industrinë e naftës që janë të rigjenerueshme
- Installimi I pajisjeve të izolimit në mënyrë që të realizohet izolimi I formacioneve që përmbajnë hidrokarbure
- Ndërtimi i një armature me cemento në hapja e grykës së pusit me lartësi rreth 2 metra mbi sipërfaqe
- Prerja e cdo tubacioni dhe atyre prodhues dhe ngjitja e një pllake në grykën e pusit

Rehabilitimi I sheshit do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme :

- Largimi I cdo pajisjeje të mbetur nga sheshi
- Largimi I cdo ndotjeje sipërfaqësore
- Nëse është e mundur të largohet mbulesa sipërfaqësore e zhavorrit nga sipërfaqja e sheshit dhe nga rruga
- Shtrimi i cdo lloj shtrese dhe'pjellor apo cdo lloj tjetër materiali të përshtatshëm për te risjellë sipërfaqen në gjëndjen e mëparshme.

Për shkak të disa kushteve në dokumentacioni e koncesionit të kompanisë, disa prej këtyre detyrave mund të ndryshojnë ose mund të kryhen në mënyra të ndryshme, por që do të merren parasysh në kohën e mbylljes dhe të rehabilitimit.

#### 2.4 Ndërtimi dhe Procesi Teknologjik

Ndërtimi I sheshit, infrastrukturës rrugore, kalimit hekurudhor dhe të lumit, do të jenë sipas standarteve që BPAL ka treguar që janë të aftë të përmbushin dhe të ruajnë. Puna do të kryhet nga një kontraktor i cili disponon licensën në lidhje me aktivitetet që do të ndërmarrë.

Gjatë aktiviteve të ndërtimit, kamionët e tonazheve të rënda që do të transportojnë gur dhe zhavorr, do të lëvizin në zonë gjatë orëve të ditës nga e hëna në të shtunë. Kjo, do të thotë se banorët dhe fermerët, përgjatë rrugëve të transportit mund të përjetojnë efekte negative, për shkak të pluhurit dhe zhurmave të shkaktuar nga kamionët gjatë kësaj periudhe. Përveç kamionëve që transportojnë zhavorr, në shesh do të sillen edhe eskavatorët, makinat niveluese dhe pajisjet e tjera të ndërtimit. Aktivitetet e ndërtimit në sheshin e pusit dhe të përmisimit të infarstrukturës rrugor do të marrin 2-6 javë.

#### Ndërtimi i sheshit:

Sheshi do të ndërtohet nga ekipi ndërtimit të BPAL duke përdorur pajisjet e përshtatshme. Vendodhja e projektit do të vlerësohet dhe do të hartohet dhe hartimi i kësaj VNM është për të kufizuar ndikimet në mjedis dhe për të eliminuar shqetësimet ekzistuese dhe materialet në dispozicion.

Sheshi do të zhveshet nga shtresa pjellore e tokës dhe më pas do të magazinohet për tu ripërdorur për e aktivitetet e ardhshme. Materiali mineral do të nivelohet në shesh dhe do të realizohet ndërtimi i taracave të ngritura rreth perimetrit të sheshit, nëse është e nevojshme do të ndërtohen edhe kanalet kulluese që do të shërbejnë për grumbullimin e ujrave sipërfaqësore në mënyrë që këto ujra të mos ndikohen nga aktiviteti industrial dhe të mos përhahen në sheshin e pusit. Instalimet elektrike dhe shërbimet e tjera të nevojshme do të jenë instaluar në mënyrë të tillë që vendi të jetë gati për procesin e shpimit.




Figura 8: Shëmbulli i ndërtimit të sheshit – Pamje profili

#### **Ndërtimi i infrastrukturës rrugore:**

Akresi rrugor do të jetë një rrugë shumë e gjatë, me kthesa dhe në disa fragmente me kthesa të ngushta. Infrastruktura rrugore do të duhet të vlerësohet, do të duhet të hartohet një plan për të siguruar gjerësinë dhe cilësinë shtrimit të rrugës në mënyrë që të sigurojë kalimin e automjeteve të tonazheve rënda. Këndet e rrugës do të duhet të zgjerohen në mënyrë që kamionet të kenë rreze të mjaftueshme kthese.

Materialet e dëmshme dhe të papërshtatshme për të formuar një shtresë bazë gjatë ndërtimit do e do të seleksionohen në grupime të ndryshme dhe ato të vlefshmet mund të ripërdoren, të riciklihen, ose dhe të asgjësohen sipas rastit. Gjithesesi shtrea e tokës do të hiqet vetëm kur është e nevojshme për qëllime të ndërtimit /ose qëllime gjeoteknike.

Për ndërtimin e rrugës do të përdoren pajisjet e përshatshme, në mënyrë që të sigurohet cilësia e rrugës sipas kërkesave dhe këto pajisje do të përdoren pas fazës së shpimit në mënyrë që të sigurohet që cdo dëmtim i rrugës. Mirëmbajtja e rrugës nuk është përgjegjësi e BPAL, por ata janë të gatshëm që të riparojnë cdo dëm mjedisor që ka rezultuar direkt nga aktivitetet të realizuar në fushën naftëmbajtëse.

#### **Kalimi i linjës hekurudhore:**

Ekzistojnë dy opsione për kalimin e sigurt të linjës hekurudhore ekzistuese e cila është jashtë funksionimit. Opsioni i arë është përmirësimi i një tuneli nën hekurudhë në mënyrë që të ketë një lartësi të përshtatshme për të lejuar kalimin e automjeteve. Ky opsion do të ishte i shtrenjtë dhe tuneli mund të përmytet në të ardhmen për shkak të motit të lagësht. Opsioni i dytë është ndërtimi i një rampave mbi shinat e hekurudhës. Ky opsion do të kishte një ndikim më afat shkurtër në këtë fragment të linjës hekurudhore që është jashtë funksionit. Megjithatë, përcaktimi e llojit të kalimit që mund të realizohte do të jetë një çështje midis BPAL dhe Agjensisë Qeveritare.

Forma e saktë dhe materialet që do të përdoren në mundësitë e kalimit të linjës hekurudhore është specifike për vendodhje të vecanta. Cdo ndërhyrje në nënkalimet apo në kalimet e shinave do të përdoren materiale ndërtimi të certifikuara në përputhje me specifikimet e rregullatorit të duhur.





*Figura 9: Shëmbull i kalimeve të shinave të hekurudhës*



*Figura 10: Shina jashtë funksionit dhe nënkalimet*



*Figura 11: Rampë provizore e automjeteve të tonazheve të rënda*

### **Kalimi i lumit (Ura):**

Kalimi i lumit mund të arrihet ose duke: 1) kalimi i lumit në një vend ku niveli i ujit është i vogël gjatë sezonit të thatë, ose 2) testimi i urës aktuale për aftësinë e ngarkesës dhe rikonstruksioni i saj, nëse është e nevojshme, ose 3) ndërtimi i një ure të përkohshme mbi lumin e Gjanicës e cila do të ndërtohet sipas specifikave që do të lejojnë peshën e automjeteve që lëvizin drejt dhe nga fusha-naftëmbajtëse.

Kalimi i lumit do të rrisë mundësinë e ndikimit në mjedis për shkak të ndërhyrjes në lumë mund të ndikohet shtrati dhe bregu i tij.

Punimet ndërtimore në urë mund të mos jenë të nevojshme ose mund të përmisojnë strukturën ekzistuese të saj, nëse është e nevojshme, ose të jenë punime për instalimin e një strukturë të përkohshme ure, që plotëson ose tejkalon kërkesat e ndërtimit shqiptar. Rikonstruksioni i urës do të jetë në gjendje për të mbështetur numrin dhe llojin e automjeteve që do të jenë të nevojshme në operacionet e ndërtimit, shpimit dhe të shfrytëzimit. Aktivitetet e ndërtimit do të zbatohen nga një kontraktor i licensuar dhe i aprovuar nga BPAL, në përputhje me planet inxhenerike.

Përmirësimi e infrastrukturës ekzistuese do të ndihmojë në ndërtimin e një ure të përkohshme ose të krijojë mundësinë e qarkullimit të përkohshëm në fragmentet e rrugës të cilat janë të pa kalueshme në gjendjen aktuale të saj.

Abutments janë formuar për të mbështetur në skajet e kuvertë urë; kalatave janë të nevojshme për të mbështetur zorrët e kuvertë. Themelet janë të nevojshme për abutments dhe kalatave. Fondacionet mund të jetë ose pad konkrete apo të grumbulluar. Elementet kryesore urë mund të jetë çeliku apo konkrete ose kombinime të këtyre. Betoni mund të hidhet në vend (in situ), ose urë mund të përfshijnë njësi parapërgaditur të cilat janë transportuar në vend. marrëveshjet e përkohshme do të bëhen për të kontrolluar e ujit sipërfaqe drejtuar-off gjatë ndërtimit për të minimizuar ndikimet në mjedis.

Ndërtimi i një kalimi të përkohshëm të lumit do të jetë i përshtatshëm për të mbështetur numrin dhe llojin e automjeteve të nevojshme për ndërtimin në vend dhe për operacionet e shpimit. Një kalim i veçantë lumi i përkohshëm do të përfshijë mbulimin e përkohshëm të rrjedhës së dhe sigurimi për një zhavorr / kuvertë konkrete rrugor lart e tombino. Lloje të ndryshme të tombinove mund të përdoren, bërë zakonisht prej betoni ose metali.



*Figura 12: Ura dhe lumi ekzistues*

Strukturat mund të hiqen ose të modernizohen (i nënshtrohen miratimit rregullator) për përfundimin e testimit të pusit dhe zhvillimit në fazën e cila do të përcaktojë nëse pusi duhet të vihet në shkallë të plotë prodhimi. Forma e saktë dhe materialet e përdorura në opsionin e kalimit të lumit varet nga natyra e urës, përfrimin e rrugës që mbart, si dhe distancat midis kalatave dhe mes kalatave dhe pikave mbështetëse (harqe) etj.






Figura 13: Projektimi i mbulesës së urës



Figura 14: Shembull i një ure të sigurt për kalimin e sondës



**Teknologjia e shpimit:**

Pusi do të shpohet duke përdorur teknologji konvencionale. Pusi do të devijohet për të siguruar që objektet nënujore të mos çënohen. This drilling technology has been used ëithin the Patos-Marinza oilfield by BPAL. Kjo teknologji shpimi është përdorur në fushnë e naftës Patos-Marinzë nga BPAL.



Figura 15: Shembull i një sonde shpimi

**2.5 Infrastruktura ekzistuese**

Infrastruktura e cila ekziston, ose është e nevojshme për të shpuar me sukses pusin do të përfshijë:

**Energjia elektrike**

Energjia elektrike është e nevojshme për të dy fazat, atë të shpimit dhe gjatë prodhimit të pusit. Nëse energjia nuk është lehtësisht e arritshme ose nëse tensioni nuk është i mjaftueshëm atëherë BPAL do të sigurojë plotësimin e burimeve të energjisë nga gjeneratorët me naftë. Sondat e shpimit zakonisht kanë aftësinë për të prodhuar enegji, pasi ato kanë kërkesa të larta për energji. Pajisjet e prodhimit mund të furnizohen nga gjeneratorë, nga rrjeti elektrike ose nga një kombinim i burimeve të energjisë në varësi të nevojave të tyre.

**Furnizimi me uje**

Uji do të përdoret gjatë fazës së shpimit, ai është i nevojshëm për përgatitjen e baltës dhe për larje. Burimet e ujit duhet të identifikohen, por megjthatë qëllimi i BPAL’s është të kufizojë ose të mos përdorë ujërat sipërfaqësore apo zonat e cekta me ujë si burim, duke e ditur që bujqësia lokale dhe popullata jetojnë me këto burime ujore. BPAL do të shpojë një pus të thellë për ujë jo të pijshëm ose do të gjejë një alternativë tjetër, për furnizim me ujë të pranueshëm burimi.

**Shkarkimet e ujrave të ndotur dhe mbetjeve**

BPAL ka ndëruar objekte të ndryshme dedikuar menaxhimit të mbeturinave në fushën naftë-mbajtëse Patos-Marinëz. Në këto facilitete përfshihen: faciliteti i përpunimit të baltës së shpimit, faciliteti i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, faciliteti i trajtimit të ujërave të zeza, gropat ekologjikedhe shesh depozitimi Kallm. Këto faciliteti do të përdoren gjatë fazës së shpimit dhe të shfrytëzimit. Nuk do të ketë shkarkime të planifikuara të ujërave ose mbetjeve nga kjo fushë në kohën kur BPAL vepron.

### **Rrugët**

Rrugët ekzistuese do të përdoren sa më shumë të jetë e mundur gjatë fazës së ndërtimit të sheshit. Rrugët e reja ose pjesët që do të rikonstruktohen do të kthehen bashkisë pas ndërtimit.

### **Infrastruktura e zonës së BPAL**

Zona naftë-mbajtëse Patos-Marinëz ka një prodhim të rëndësishëm të naftës e cila lidhet edhe me infrastrukturën. Kjo infrastrukturë është e rëndësishme për të gjitha operacionet në fushën-naftë mbajtëse dhe është projektuar dhe ndërtuar posacërisht nga BPAL për prodhimin e llojit të naftës që është gjetur në këtë fushë naftë. Këto objekte kanë një qëllim të vecantë dhe të dhënat mund të gjenden në VNM-të përkatëse dhe të dokumenteve për leje.

## 2.6 Programi i ndërtimit

Në këtë seksion jepen informacione në lidhje me kohëzgjatjen e projektit, datën e përfundimit dhe planin e rehabilitimit të zonës pas përfundimit të projektit.

Tabela 5: Kohëzgjatja e projektit

	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
	2016				Në të ardhmen
Sheshi dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore					
Shpimi dhe përfundimi					
Prodhimi					
Mbyllja e pusit					
Rehabilitimi i sheshit					

Mbyllja dhe rehabilitimi i pusit do të përfshijë heqjen e të gjitha pajisjeve sipërfaqësore, mbylljen e grykës së pusit sipas procedurave ndërkombëtare, rehabilitimin e tokave të ndotura në fushë, heqjen e materialeve në sheshit dhe gjatë rrugëve, nëse kerkohet.

## 2.7 Strukturat që do të ndërtohen përfshijnë

Strukturat që do të ndërtohen përfshijnë: sheshin, rrugët ndihmëse, kalimet mbi lumë/urë dhe kalimet mbi hekurudhë.

### Vendëndoshja:

Vendodhja e shpimit është e lokalizuar në një sipërfaqe tokë bujqësore ekzistuese. Kjo zonë do të pastrohet, do të nivelohet dhe do të ndërtohen kanale kulluese dhe berma me materiale të përshtatshme.

### Infrastruktura rrugore:

BPAL ka ndërtuar dhe ka rikonstruktuar rrugët ekzistuese në fushë naften Patos-Marinzë dhe në Bllokun F. Kjo përfshin rrugë të asfaltuara dhe me zhavorr. BPAL ka pajisjet e nevojshme dhe personelin për të përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe sheshin e shpimit që është e nevojshme për shpimin e këtij pusi.




Figura 15: Example of Road Construction Design

#### Ura:

Urat e përkohshme janë përdorur për shumë shërbime të ndryshme. Urat e përkohshme të prodhuara mund të ndërtohen për të mbajtur peshën e automjeteve të rënda. Një kontraktues i prodhimit të urave do të duhet të sigurojë që ura është ndërtuar sic duhet dhe që plotëson kërkesat dhe inspektimet.

#### Kalimi i shinave të hekurudhës:

Linja hekurudhore është përcaktuar të jetë e papërdorur por gjithsesi binarët janë akoma të pranishëm. Ka një tunel ekzistues, por nuk është i gjerë dhe i gjatë mjaftueshëm për të lejuar kalimin e kamionëve që transportojnë pajisjet e ndërtimit dhe të shpimitqë do përdoren. Ka dy opsione që janë duke u marrë në konsideratë.

Ngritja e tunelit. Kjo gjë do të kërkonte që të bëhej gërmimi më tej i tunelit dhe të mbështetja e tij në mënyrë adekuate. Për të mundur këtë përmirësim duhet që qeveria shqiptare të lejojë këtë punë që të bëhet dhe të bëhet vlerësimi i duhur dhe palni inxhinierik.

Rampat mbi linjat hekurudhore. Kjo do të krijonte më pak përcarje, por gjithsesi qeveria do të duhej të jepte leje që të vazhdonte kjo punë. Rampat do të duhet të vendosen në një zonë e cila siguron një shkallë relativisht të cekët dhe mund të hiqen pasi të jetë shpaur pusi dhe pasi të jenë zhvendosur pajisjet e prodhimit nga vendndodhja, rampat mund të jenë prej çeliku.

## 2.8 Lënda e parë – Ndërtimi

Ndërtimi i projekteve të ndryshme do të realizohet me materiale të ndryshme.

#### Rrugët e kalimit dhe Zona e Projektit:

Lëndët e para për ndërtimin e këtij projekti do të jenë të kufizuara në materiale minerale. Furnizimi me këto materiale do të bëhet nga furnizuesit lokalë ose do të sigurohen nga rezervat e materialeve inerte të

BPAL. Sasia e materialit që do të përdoret nuk është përcaktuar akoma, por mund të mendohet se materiali do të jetë i nevojshëm si për rrugët e kalimit ashtu edhe për zonën e Projektit.

**Ura:**

Një urë e përkohshme prej çeliku dhe druri do të ndërtohet. Këto lloj urash janë përdorur në situata të tjera në fushat naftë-mbajtëse dhe janë ndërtuar për të përballuar peshën e pajisjeve të shpimit dhe pajisjeve të prodhimit që ngarkohen në një automjet. Specifikat e ndërtimit të urës do të duhet të përcaktohen dhe të ndërtohen në një kantier të përshtatshëm, si ai i BPAL Patos-Marinzë.

**Kalimi hekurudhor:**

Në varësi të opsionit të kalimit hekurudhor, për përmirësimin e tunelit do të duhet të përdoren pajisjet gërmuese dhe shpuese. Muret dhe tavani i tunelit duhet të përforcohen strukturalisht. Kjo punë kërkon të kryhet nga një kontraktor për ndërtime hekurudhore, pasi nevojiten pajisjet e duhura dhe masat përkatëse të sigurisë për këtë punë të rrezikshme.

Nëse hekurudha është e pjerrët, atëherë rampat mund të ndërtohen në bazë të specifikimeve të prodhuesit, pjesërisht ose të gjitha në kantjerin e BPAL dhe transportohen në zonën e projektit. Rampat do të prodhohen nga çeliku dhe / ose druri. Inspektimet e rampave duhet të kryhen për të siguruar materialet, saldimet dhe inspektimin e materialeve të tjera të kalimit.

**2.9 Lidhjet me projektet ekzistuese**

Blloku F është pusi i parë në zonë që do të shpohet nga BPAL. BPAL nuk ka objekte të tjera ose veprimtari lidhur me fushën naftë-mbajtëse në këtë zonë. Infrastruktura në Patos-Marinzë do të përdoret për trajtimin e hidrokarbureve dhe shitjet meqënëse nuk ka infrastrukturë të njëjtë në Bllokun F.

**2.10 Alternativat e projektit**

Alternativat e projektit dhe zgjedhja e teknologjisë janë të përcaktuara nga inxhinierët e BPAL dhe bazohen në përmbushjen e kërkesave të projektit, i tillë si pusi i prodhimit të hidrokarbureve. Alternativat e projektit të cilat janë konsideruar bazohen në numrin e puseve që pritet të shpohen në të njëjtin vend, krahas llojit dhe sasië së pajisjeve të prodhimit sipërfaqësor të nevojshëm.

Alternativat e projektit janë:

- Alternativa 1 – Pa projekt
- Alternativa 2 - Shesh me një pus
- Alternativa 3 –Shesh me shumë puse

*Tabela 6: Vlerësimi i Alternativave të Projektit*

Ndikimet	Pa projekt	Pusi	Disa puse
Cilësia e ajrit	0	-	--
Mjedisi	0	-	--
Përdorimi i tokës	0	-	-
Peisazhi	0	-	--
Mundësitë për vende të reja pune	---	+	++
Cilësia e jetës	---	+	++

Zhvillimi ekonomik i zonës	---	+	+++
Infrastruktura	--	+++	+++
Zhurmat	0	-	-
Ekonomia kombëtare (nga taksat)	---	+	+++
<b>Vlerësimi i Alternativave</b>	<b>-14</b>	<b>2</b>	<b>5</b>
Legjenda: '0' – pa ndikim, '-' - ndikim negativ, '+' – ndikim pozitiv			

Bazuar në tabelën e Vlerësimit të Alternative të Projektit, paraqitet rezultati më pak i dëshirueshëm i projektit kur nuk ka asnjë projekt dhe rezultati më i dëshirueshëm i projektit është ai me shumë puse.

Për këtë pus kërkimor BPAL ka përcaktuar se një rrugë e drejtuar edhe shpuar nga një vend sipërfaqe për të kompensuar vende target nënujor do t'i japë shansin më të mirë të intersecting zonat pritshme rezervuar. Kjo metodologji e shpimit, do të lejojë inxhinieret dhe gjeologët e BPAL për të mbledhur sa më shumë informacione në lidhje me formacionet e rezervuarit, sa më shumë të jetë e mbur. Hapja e këtij pusi do t'u mundësojë inxhinierëve dhe gjeologëve të BPAL të mbledhin sa më shumë informacion të jetë e mundur në lidhje me formacionet e rezervuarit. Në momentin kur provohet ekzistenca e hidrokarbureve në këtë zonë atëherë BPAL mund të konsiderojë teknologji të ndryshme shpimi.

### 2.11 Lëndët e para – Funktionale

Lëndët e para të përdorura gjatë shpimit dhe prodhimit të hidrokarbureve janë të kufizuara në energjinë elektrike, naftë dhe benzinë. Mund të ketë përdorim të kimikateve dhe ujit që mund të përdoren gjatë fazës së mundshme të injeksionit të polimereve në të ardhmen.

Tabela 7: Lëndët e para për Shpimin dhe Veprimtaritë e Prodhimit

Lëndët e para	Burimi	Konsumi i përgjithshëm në vit
<b>Energjia Elektrike</b>	Energjia elektrike përdoret për të furnizuar me energji pajisjet ndihmëse si ndricimi, pompat etj. gjatë shpimit dhe prodhimit.	I panjohur në këtë pikë, në pritje të rezultateve të testimit të pusit.
<b>Naftë</b>	Për prodhimin kryesor të energjisë dhe furnizimin e pajisjeve gjatë fazave të shpimit dhe shfrytëzimit. Naftë për të furnizuar kamionat për grumbullimin / depozitimin e materialit.	I panjohur deri tani.
<b>Benzinë</b>	Benzinë për furnizimin e tankeve të nxehtësisë	I panjohur sepse do të varet nga aftësia për të nxjerrë dhe përdorur benzinën e prodhuar nga nafta.

### 2.12 Aktivitetet lidhur me Projektin

Këto aktivitete mund të përfshijnë ndërtimin e kampeve apo objekteve të tjera të shërbimit bazë, megjithatë për këtë projekt, të gjithë punëtorët do të vendosen jashtë qytetit të Fierit, do të transportohen në vendodhjen e projektit me anë të mjeteve të kompanisë dhe të gjitha shërbimet do të

ofrohen në zonë gjatë shpimit dhe veprimtarisë. Deri më tani, shërbime të tjera nuk janë identifikuar si të nevojshme.

Blloku F është pusi i parë në zonë që do të shpohet nga BPAL. BPAL nuk ka objekte të tjera ose veprimtari lidhur me fushën naftë-mbajtëse në këte zonë.

Megjithatë, ka disa puse në pronësi të Albpetrol në afërsi të vendit të propozuar. Gjatë inspektimit të zonës është vërejtur vetëm një pus funksional (Kreshpan 4). Vendodhjet e projekteve të Albpetrol disponojnë rrugët ekzistuese të kalimit të cilat mund të përmirësohen sipas nevojës për të lehtësuar kalimin në vendodhjen e shpimit.

### **2.13 Informacion mbi Liçensat dhe Lejet**

Lejet e nevojshme përfshijnë një Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedis dhe Leje Tipi A. Leja e Tipit A do të përfundojë në momentin që janë marrë të gjitha miratimet e duhura.

### 3 Alternativat e Projektit

Ekzistojnë gjithmonë disa alternativa për cdo projekt. Disa alternativa mund të përfshijnë; mos zhvillimin e projektit, kohëzgjatjen e projektit, vendndodhjen e projektit, rrugët e kalimit dhe menaxhimin e mbetjeve dhe ndikimet mjedisore të secilit.

BPAL është në një pozicion ku eksplorim i potencialit të prodhimit të hidrokarbureve të Bllokut F duhet të provohet. PSA kërkon që një vlerë minimale të shpenzohet në eksplorim brenda një periudhe kohore të caktuar. Ky pus do të kontribuojë në përmbushjen e kësaj kërkesë. Alternativa është që të paguajë gjobën për mos-aktivitet. Ndikimi mjedisor i mos zhvillimit të projektit do të ishte pozitiv, por ekonomikisht do të kishte efekte negative si për BPAL ashtu edhe për qeverinë shqiptare .

Kohëzgjatja e projektit ka alternativa të kufizuara në bazë të kufizimeve të përshkruara nga marrëveshjet qeveritare. Nëse BPAL vazhdon më tej me shpimin e këtij pusi duhet që të respektohen afatet. There is no direct environmental impact related to timing for this project. Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis në lidhje me kohëzgjatjen e këtij projekti.

Vendndodhja e sheshit është e varur nga gjeoshkenca e BPAL identifikimi i vendeve të mundëshme ku formacionet e lidhura të hidrokarbureve mund të ndodhin në bazë të informacioneve të disponueshme

Vendndodhja e shesheve është e vlerësuar nga gjeologët e BPAL për identifikimin e vendndodhjeve më të mundshme të formacioneve të hidrokarbureve, duke u bazuar në të dhënat e disponueshme. Janë identifikuar tre vendndodhje si më të mundshme nga dhjetëra vende të tjera. Ndikimi mjedisor i vendndodhjes tashmë është i kufizuar dhe nuk është më një shqetësim.

Qasja nga sipërfaqja e tokës në zonat nënujore është studiuar dhe është diskutuar gjerësisht. E gjithë sipërfaqja është studiuar, ajo mund të supozohet se ka shumë zona nënujore dhe këto janë më të mirat. Hyrja në puse do të bëhet me kombinim e rrugëve ekzistuese dhe atyre që do të rikonstruktohen për të mundësuar lëvizjen e automjeteve të rënda. Ndikimi mjedisor nga ky aktivitet do të ndihet, megjithatë kominuteti do të përfitojë nga rrugët e përmirësuara.

Nuk kemi shumë alternativa për metodat e menaxhimit të mbetjeve. BPAL ka shpenzuar fonde të konsiderueshme dhe njohuri inxhinierike për të ndërtuar dhe për të ruajtur objektet e menaxhimit të mbetjeve brenda PM, të cilat plotësojnë nevojat specifike të industrisë së naftës. Me kalimin e kohës këto objekte kanë vërtetuar që ato funksionojnë, kështu që nuk ka asnjë arsye për të vlerësuar dhe për të ofruar alternativa të tjera.

Ata kanë punuar shumë për të përsosur shpimin, operacionet e prodhimit, mbylljen e mirë dhe rehabilitimin e sheshit, sipas proceduarve dhe standarteve të BPAL. Ata veprojnë me standartete ndërkombëtare dhe janë krenarë për këtë arritje. Duke patur parasysh aktivitetin industrial, ndikimi mjedisor nga ky aktivitet është projektuar të jetë sa më i vogël.



## 4 Përshkrimi i mjedisit

Vlerësimi paraprak i ndikimit në mjedis për Bllokut F sheshi F35a përshkruan kushtet mjedisore. Informacioni i paraqitur në këtë seksion është një përmbledhje dhe është i kufizuar në rajonin e Bllokut F.

### 4.1 Kushtet fizike

#### 4.1.1 Klima

Bazuar në Atlasin e Kushteve Klimatike të Shqipërisë, zona e studimit është vendosur në zonën e Detit Mesdhe që mbulon bregdetin e Shqipërisë. Ky rajon karakterizohet me verë të nxehtë dhe me dimër të butë e të lagësht. Sasia e reshjeve mesatare vjetore është rreth 1100 mm/vit (950-1200mm) dhe pjesa më e madhe është e përqëndruar gjatë periudhës tetor-mars.

Temperatura mesatare vjetore varion nga 16 deri në 20°C, me temperaturat më të larta të regjistruara gjatë periudhës korrik-gusht me një maksimum prej 35 deri në 40°C. Temperaturat më të ulëta janë matur në janar dhe mund të shkojnë deri në -5°C. Faktorët që ndikojnë në klimën e zonës janë afërsia me detin Adriatik dhe topografia e zonës.

#### 4.1.2 Gjeomorfologjia

Vendëndodhja e projektit është tokë bujqësore ekzistuese që përdoret nga fermerët. Nuk u gjetën shenja të eksplorimit të mëparshëm apo të nxjerrjes së naftës në shesh, gjithësi është lokalizuar një pus nga ish Albpetol përafërsisht 45 m në veri lindje. Nuk ka dëshmi të aktivitetit të mëparshëm të industrisë së naftës të regjistruar në vëndin e propozuar nga BPAL. Sheshi duket tepër i lirë dhe pa karakteristika ujore sipërfaqësore apo kanale të kullimit në vënd. Ka dëshmi për një pus aktiv të Albpetrol të lokalizuar rreth 750 m në lindje të sheshit, ky vend është vërejtur të jetë në punë në kohën e vizitës dhe të identifikojë ndotjen e konsiderueshme të hidrokarbureve.



Figura 16: Pamje e sheshit të zhvillimit

Zona e Fierit ka qënë e zhvilluar si një qëndër industriale në Shqipëri. Shumë për të mos thënë e gjithë sipërfaqja gjeomorfologjike ka ndryshuar nga zhvillimi urban, bujqësia dhe industria e hidrokarbureve.

Gjeomorfologjia e zonës ka kodra dhe kodrina, lumenj gjarpërues dhe bimësi mesdhetare. Lumi i Gjanicës dhe Lumi i Semanit janë lumenjtë kryesorë të cilët janë përdorur për ujitje.

Ndikimi i njeriut tek gjeomorfologjia ka qënë përmes kultivimit apo jo të tokave dhe parcelave të vogla bujqësoretë cilat janë kultivuar në mënyrë aktive apo që janë lënë djerrë, apo braktisur. Infrastruktura është ndërtuar rreth qendrave urbane, megjithatë zhvillimi historik ka pasur një infrastrukturë të kufizuar të transportit e cila ka rezultuar me njerëz që jetojnë në zonat naftë-mbajtëse.

#### 4.1.3 Gjeologjia

Gjeologjia rajonale e Shqipërisë është e përshkruar si banues ndërmjet pllakave tektonike Euro-Aziatike dhe atyre Afrikane dhe gjeologjia kontrollon nga evolucioni i Albanideve. Periudhat aktive tektonike kanë rezultuar në të dy shtetet të zmadhuara dhe kompresive, duke rezultuar kështu në një seri të blloqeve të ngritura dhe të formimit të strukturave që cojnë në rrëshqitjen e një muri të varur dhe mjedise të vecanta depozitimi.

Burimi i hidrokarbureve shkemb është identifikuar nga fundi i Triasik-ut mes periudhave të Eocene. Migrimi dhe formimi i rezervuarit është identifikuar në pesë kohë të ndryshme nga fundi i Kretakut përmes Paleogjenit (Eocene dhe Oligocenit) dhe në fund të Miocenit/Pliocenit. Më poshtë është një pasqyrë e shkurtër e Kretakut të vonshëm dhe të depozitimeve të Kuaternarit (hidrokarbure rezervë) në fushën e pusit 5063.




Figura 17: Harta gjeologjike e zonës në studim

#### Depozitimet e Oligocenit të sipërm (Pg33)

Depozitimet e Oligocenit të sipërm përfaqësohen nga depozitimet flishore Argjilo - Ranoreme shtresa gëlqerorësh dhe ranorësh masive. Në përgjithësi të gjithë shtresat gëlqeroreve në tavan kalojnë gradualisht në mergele argjilore. Nga lindja në perëndim vërehet dhe rritja e numërit të horizonteve

vithisë. Në pjesën e sipërme të depozitimeve të Oligocenit të sipërm predominojnë ranoret të cilët heraherës kalojnë në ranore masive. Në depozitime janë të reduktuara dhe përfaqësohen nga flish argjilor që i përket formacionit "Sefaj". Depozitimet e Oligocenit të sipërm pësojnë ndryshime të theksuara nga lindja në perëndim dhe nga jugu në veri. Depozitimet e Oligocenit të sipërm në sipërfaqe kanë marrëdhënie pajtuese me depozitimet e mëposhtme të Oligocenit të mesëm. Në depozitimet e Oligocenit të sipërm janë veçuar zonat faunistike planktonike me Globigerina ciperoensis ciperoensis dhe Globorotalia.

#### **Depozitimet e Akuitanianit (N11a)**

Depozitimet e Akuitanianit në pjesën e poshtme përfaqësohen nga ndërthurje ranoresh të trashë deri masive me shtresa të holla argjilash e alevrolite. Këto depozitime pësojnë ndryshime të theksuara litologjike, duke kaluar heraherës në flish të hollë argjilo-alevrolito-ranore. Karakteristike për depozitimet e pjesës së sipërme është prania e argjilave mergelore, të cilat gradualisht shtohen në prerje dhe që përkojnë me formacionin "Levani", i cili vazhdon edhe në Burdigalian. Në tërësi këto depozitime vendosen në vijushmeri normale mbi ato të Oligocenit të sipërm. Trashësia e depozitimeve të Akuitanianit luhaten nga 400m,1100 deri në 1400m në të gjithë zonën Jonike.

#### **Depozitimet e Burdigalianit (N11b)**

Depozitimet e Burdigalianit përfaqësohen nga ndërthurje paketash mergëlore, argjila mergëlore, ranorësh dhe shtresa gëlqerorësh lithothamnike. Në pjesën e poshtme prerja karakterizohet nga ndërthurje të paketave ranorike me ato argjilo-alevrolitore dhe horizonteve vithisë. Mbi këtë prerje vazhdojnë ndërthurje me predominim të mergëleve të cilët ndërtojnë pako të fuqishme. Ky ndryshim litologjik i prerjes në vertikalisht, përkon dhe me shfaqjen e zonave faunistike Globorotalia acrostoma-G. scitula.

Mergëlet që përbëjnë dhe komponentin kryesor në prerje, janë me ngjyrë gri të zbardhur, me thyerje guackore, kompakte dhe me trashësi të paketave që arrijnë nga 0.5-1m deri 3-8m. Dhe rrallë 15-20m. Argjilat janë me ngjyrë gri të kaltërt, shpesh paraqiten alevrolitore në trajtën e paketave me trashësi 1-3 deri 5m. Ranoret janë relativisht kompakt herë-herë me pamje konkrecionale kokërr madh dhe kokërr mesëm, teksture masive dhe granoklasim të qartë vertikal. Trashësite e shtresave të tyre luhaten nga 10-15 cm deri në 0.5-1m. dhe rrallë arrin deri 10m.

Horizontet vidhisës janë me karakteristike për pjesën e poshtme të Burdigalianit, përbëhen kryesisht nga përzjerje të materialit argjilor e argjilo-alevrolitor me copera e blloqesh ranorësh të flishit si dhe zaje të shumtë gëlqerorësh e me pak të shkëmbinjve magmatike. Depozitimet e burdigalianit vendosen transgresivisht mbi depozitimet me të vjetra.

Përhapje të konsiderueshme këto depozitime duhet të kenë dhe nën Ultësirën Adriatike në zonën e Adriatikut jugor. Në sipërfaqe ato takohen në një rajon të kufizuar. Trashësia e depozitimeve të Burdigalianit në zonën Jonike lëviz nga 80-40 m deri - 1100-3000m.

#### **Depozitimet e Langianit (N12I)**

Depozitimet e Langianit marrin pjesë në ndërtimin e kraheve dhe mbylljeve centriklinale e periklinale të rrudhosjeve tërrigjene. Në daljet sipërfaqësore kanë pamjen e brezave shume të ngushte, duke shoqëruar në të shumtën e rasteve depozitimet e Burdigalianit. Dyshemeja e këtyre depozitimeve nga ana litologjike ka vështirësi për tu trasuar në terren, ajo përkon me çfaqjen e argjilave karbonatike me shumicë. Në përgjithësi këto depozitime kanë marrëdhënie suksesive me depozitimet e nënshtrira. Litologjikisht depozitimet e Langianit përfaqësohen nga ndërthurje paketash mergëlore, argjilave-mergëlore dhe shtresave të ranoreve e gëlqeroreve bioklastike. Mergëlet takohen kryesisht në pjesën e poshtëme të prerjes litologjike. Në nivelet e moshave me të reja ato zevëndësohen gradualisht prej argjilave-mergëlore

deri në argjila. Mergëlet paraqiten me ngjyre gri të zbardhur, shtresore, kur alternohen nga alevrolite ose ranore në tavan e dysheme dhe në trajtën e paketave e pakove masive, trashësite e të cilave arrijnë deri në 7-8m .Argjilat kanë ngjyrë gri deri gri të errët me nuanca jeshile dhe ndërtim guaskor. Shpesh herë i ndesh në trajtë shtresash të holla 0.5 deri 2m. Ranorët paraqiten me ngjyrë gri të zverdhur deri kafe, kokërrimet deri kokërrmesëm me trashësi 0.3 deri 0.7m. Gëlqeroret janë me ngjyre gri në bezhë me çopra ose gravelite deri zaje në bazë dhe gradualisht drejt tavanit kalojnë në mikritike e mergële. Shtresat e gëlqeroreve, zakonisht kanë trashësi 0.5 deri 1m dhe në disa rajone ato arrijnë deri 5-6m. Depozitimet e Ultësirës Pranë Adriatike përfaqësohen nga depozitimet e mëposhtëme:

**Depozitimet Messinianit (N13m)**

Depozitimet e Messinianit ndërtojnë pjesën jugore të monoklinalit të Patosit nga kodrat e Krapsit, në Visokë e deri në Rruzhdie nga këto depozitime ndertohet edhe berthama e strukturës antiklinale e Stan-Karbanarës. Nga ana litologjike këto depozitime përfaqësohen nga dy litofacie, litofacia litofacia ranoro-argjilore dhe nga facia argjilo-ranore. Litofacia ranoro-argjilore përfaqësohet nga ndërthurje paketash ranorike me paketa argjila-alevrolitore. Ranoret predominojnë në prerje dhe paraqiten në trajtën e paketave me trashësi 6-7m. deri 15-20. Në pergjithesi janë kokerndryshem, me shtresëzim të pjerret dhe rrallë herë verehen dhe zaje të vegjël midis ranorëve. Argjilat kanë pamje me tepër alevrolitore dhe paraqiten me ngjyrë gri hiri. Litofacia argjilo-ranore, ndryshe nga ajo ranoro-argjilore, karakterizohet për një ambient të thellë ku në pergjithesi predominojnë argjilat. Argjilat paraqiten në trajtën e paketave të trasha. Ranorët paraqiten shtresorë, por me përhapje të kufizuar dhe të tipit linzor të formave gjenetike kryesisht kanalore.

**Depozitimet Pliocenike**

Nga pikëpamja statigrafike këto depozitime ndahen qartë në dy suita, Rrogozhina dhe Helmësi.

**Depozitimet e Pliocenit të poshtëm (N21h) (Suita "Helmësi")**

Depozitimet e formacionit "Helmësi" fillojnë me shfaqjen në prerje të shtresave ranore dhe konglomerateve të pangopur që përcaktojnë dyshemenë e tij dhe shënojnë, praninë e trasgresionit Pliocenik. Në zonën e studimit ata kanë përhapje të madhe. Mbi shtresat ranore dhe konglomeratike prerja vijon me shtresa argjilore dhe paketa argjilo-ranore shtresë hollë e shtresë mesëm deri në praninë e argjilave masive. Ranorët kanë forma shtresore me trashësi nga 4-8 cm deri në 20-30 cm, ngjyrë hiri të verdhe, të shkrifët e me çimentim të dobët. Ata janë kokërrvegjël dhe kokërrm mesëm, polimineral. Argjilat predominojnë në prerje, janë gri deri në të kaltëra, të buta deri në kompakte herë-herë shumë mikore. Konglomeratet përbëhen nga zaje të përbërjes dhe formave të ndryshme. Takohen zaje të rrumbullakosura me madhësi mesatare 4-10cm.

**Depozitimet e Pliocenit të mesëm (N22r) (Suita "Rrogozhina")**

Këto depozitime në thellësi shtrihen nën depozitimet Kuaternare. Në prerjen e plotë të Pliocenit e mesëm përfshihet pjesa e sipërme e formacionit Helmësi dhe tërësisht formacioni "Rrogozhina". Në prerje takohen argjila shtresore herë-herë me pamje masive që shpesh ndërthuren me paketa argjilo-ranore ritëm hollë me trashësi shtresash nga 4 deri 8cm, si dhe me ndërshtresa alevrolitesh dhe ranorësh me trashësi 15-50cm. Litologjikisht këto depozitime përfaqësohen nga ndërthurje e konglomeratëve, ranorëve dhe argjilave. Si rregull në pjesët e poshtëme të prerjes të kësaj pakoje mbizotërojnë shtresa ranore e alevrolitore me argjila ndërsa në pjesën e sipërme predominohet nga konglomerate dhe ranore. Konglomeratet përbëhen nga copëra me dimensione kryesisht kokërmadhe dhe me rrallë kokërrvogël, kryesisht të rrumbullakosura me dimensione nga 4-15 cm. Ato kanë përbërje të ndryshme (gëlqerore, ranore dhe magmatike). Ngjyra e tyre është gri e errët deri në gri. Trashësia e kësaj pakoje ndryshon nga 2-5 deri në 25 m. Ranorët janë kryesisht kokërrvegjël deri në kokërrmesëm, por takohen edhe kokërtrashë




të çimentuar. Argjilat janë kryesisht plastike dhe kanë ngjyrë në të gjelbërt. Trashësia e tyre mund të shkojë deri në 4 m. Trashësia e formacionit "Rrogzhina" në prerjen e Patosit është 50m,

**Depozitimet e Kuarternarit (Qp-h)**

Depozitimet e Kuarternarit kanë përhapje të konsiderueshme në rajon ku ndodhet sheshi i pusit. Këto depozitime i përkasin moshës Qp-h (Pleistocen - Holocen) dhe janë kryesisht depozitime të përziera aluviale – proluviale me përbërje kryesisht ranore alevrolitore dhe zhavore.

**4.1.4 Sizmiologjia**

Zona në të cilën ndodhet zona e studimit bën pjesë në kufirin midis zonave gjeologjike Joniane dhe Ultësirës pranë Adriatikut. Në veri e verilindje kufiri i zonës Joniane përkon me kufirin e orogjenit, duke hyrë në një shkallë të konsiderueshme mbi zonën e Adriatikut Jugor. Bazuar në hartën sizmike të rajonit zona e projektit ndodhet në zonën me intensitet të lart sizmik, Zona VIII.



Legjenda:



Seismic activity zone VIII Balle

Seismic activity zone VII Balle

## Seismic activity zone VI Balle

Figura 18: Zonat me aktivitet sizmik në Shqipëri

### 4.1.5 Ujërat sipërfaqësore

Pellgu i lumit Seman ka katër lumenj: Semani, Osumi, Devolli dhe Gjanica .Lumi Gjanicë është brenda zonës së studimit.

Lumi Gjanica është përdorur për ujitje, bagëtinë dhe është shumë i ndotur për shkak të aktiviteteve të kaluara në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz dhe nga Rafineritë e Ballshit. Përpyekjet e mëdha rehabilituese që janë bërë nga kompanit ndërkombëtare të nxjerrjes së naftës kanë rezultuar në përmirësim të dukshëm të cilësisë së ujit të lumit, megjithatë ujrat e zeza, ujrat nga rrjedhet bujqësore dhe erozioni janë ende rreziqe të larta të ndotjes.

### 4.1.6 Ujërat nëntokësore

Në bazë të hartës hidrogeologjike sheshi i pusit ndodhet në një zonë të varfër me ujëranëntokësore. Në ndërtimin hidrogeologjik të zonës bëjnë pjesë këto komplekse ujëmbajtëse hidrogeologjike:

- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Kuarternarit
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Pliocenit të mesëm (N22rr)(sua Rrogozhinë)
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Pliocenit të poshtëm (N21h) (sua “Helmasi”)

#### **Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Kuarternarit**

Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Kuarternarit përkatësisht të katit pleistocen holocen kanë një përhapje të kufizuar në zonën e pusit. Përbërja litologjike e tyre është kryesisht argjilore e argjilo ranore dhe zhavorore. Këto depozitime përfaqësohen nga aluvione -proluvione.Karakteristik për këtë kompleks është se nuk kanë lidhje të mira hidraulike ndërmjet ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore. Ujëpërcjellshmëria është tepër e ndryshme. Ujërat nëntokësore janë të ëmbla dhe me fotësi të ulët. Rezervat ujore janë të vogla dhe mund të shfrytëzohen në depozitimet e konusve të derdhjes dhe të depozitimeve lumore të lumit të Gjanicës që ndodhet afër zonën së pusit..

#### **Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të pliocenit të mesëm (N22 r)**

Depozitimet e këtij kompleksi ujëmbajtës kanë përhapje të gjerë në sipërfaqe dhe në thellësi. Kompleksi ujëmbajtës takohet në sipërfaqe në rajonin e studiuar në zonat kodrinore të Kreshpanit.Ujëmbajtja dhe vetite filtruese të suitës “Rogozhina” në mungesë të të dhënave në zonën e studimit e kemi marrë për analogji me në zona të ngjashme të studiuar në kompleksin ujëmbajtës të suitës Rrogozhina. Duke gjykuar sipas kësaj llogjike, nga mund të pranojmë se prurja specifike luhetet nga 0.016 l/sek/m deri në 1.2 l/sek/m. kurse koeficienti i filtrimit nga 1-7 m/ditë. Zona e ushqimit e këtij kompleksi bëhet kryesisht nga rreshjet atmosferike ku këto depozitime dalin në sipërfaqe ku siç është theksur përhapja e tyre në sipërfaqe është kryesisht në zonën e studimit.

#### **Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Pliocenit të poshtëm (N21h ) (sua “Helmasi”)**

Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve suitës “Helmasi” ka një përhapje më të kufizuar në sipërfaqe në zonën e pusit. Vetitë ujëmbajtëse të këtij kompleks janë shumë të ulta dhe pa ndonjë rëndësi praktike për furnizim me ujë komunal dhe ujë të pishëm.






Figura 19: Harta hidrologjike e zonës në studim

## 4.2 Biodiversiteti

Informacioni në dispozicion për biodiversitetin është i bazuar vetëm në të dhënat rajonale. Cilësia dhe mosha e këtyre të dhënave nuk mund të përcaktohet dhe për këtë arsye është shumë e përgjithshme. Biodiversiteti i zonës, flora dhe fauna janë zakonisht specie mesdhetare. Në afërsi të projektit nuk ka zona të mbrojtura apo zona të ndjeshme mjedisore.

### Peisazhi

Peisazhi në këtë fushë është i përfaqësuar kryesisht nga toka të varfëra dhe me vlerë të ulët biodiversiteti. Peisazhi ndryshon nga lugina që kanë bimësi relativisht të dendur me lumenj me vëllim të ulët, për të vazhduar me tarracat me pemë dhe drurë frutor e deri tek kodrat shkembore me perime. Kodrat janë gëlqerore dhe janë të ekspozuara ndaj erës, diellit dhe reshjeve të pakta apo sezonale, duke rezultuar në habitatin e dobët për rritjen e sukseshme të bimëve. Megjithatë ka një numër të ulët të llojeve të bimësisë që rritet në të carat e shkembinjve të cilat janë përshatur me këto kushte.

### Bimësia

Tokat natyrore me bar janë të pranishme në zonë studimit. Këto habitate janë ndikuar prej kohësh nga aktiviteti njerëzor që rezulton në zhdukjen e pemëve dhe të shkurreve dhe nuk ka biodiversitet të lartë apo shumëllojshmëri të luleve. Këto toka natyrore janë historikisht toka të cilat janë përdorur për kullotë.

Bimësia është një përzierje e pyjeve të degraduara me gjelbërim të përhershëm të Mesdheut apo pyjet e vjetër me lisa, të cilët kanë gjelbërim të të përjetshëm ku dominuese janë shkurret në zonat kodrinore. Këto bimësi janë përshtatur që të rriten në mot të nxehtë dhe në mungesë të reshjeve të shiut. Pyjet shpesh janë të copëtuara dhe kanë një bimësi të ulët dhe të lartë, shpesh me shkurre të tilla si manaferrat, driza, shqopa dhe bimë barishtore si trumëza e malit.

Tokat bujqësore janë të përhapura në zonën e studimit. Parcela të vogla të tokave bujqësore gjenden shpesh gjatë vendbanimeve të vogla. Kulturat bujqësore më të lashta që kultivohen në këtë zonë janë misri, fasulja, elbi dhe jonxha. Pemët e ullinjve dhe vreshtat janë tipike për këtë zonë dhe sidomos për zonën e kodrave. Disa ullishte janë në gjendje të mirë ndërsa disa të tjera janë braktisur.

### **Zonat e mbrojtura**

Shqipëria ka identifikuar zonat të cilat kanë statusin e zonës së mbrojtur në Shqipëri. Nivelet e statusit janë ose “Emerald” ose “Ramsar”, të cilat janë të lidhura me Rrjetin Ndërkombëtar dhe Shqipëtar e cila përfshijnë parqe kombëtare, rezervate të menaxhuara (me nivele të ndryshme të mbrojtjes) dhe Monumenteve Natyrore. Në Shqipëri, rrjeti aktual i zonave të mbrojtura është projektuar për të përmbushur objektivat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar (ligjeve, akteve nënligjore, konventat, marrëveshjet, etj) për mbrojtjen e mjedisit natyror.

### **Klima**

Klima e Shqipërisë është mesdhetare me male të larta dhe me ultësira bujqësore. Blloku F është i vendosur në Ultësirën Jugore dhe ka një klimë në përgjithësi të butë, dimër të lagësht dhe të ngrohtë, verë me lagështi.

Stuhitë janë të shumëta dhe ndodhin në të gjitha stinët e vitit. Reshjet e rënda janë tipike në dimër dhe në pranverë, që shpesh ka stuhi me breshër. Shirat e mëdha zakonisht rezultojnë me përmytje të cilat në të kaluarën kanë shkaktuar dëme të mëdha në zonat e banuara. Përpjekjet për mbrojtjen nga përmytjet janë duke u ndërtuar në Fier, mirëpo fshatrat e vogla kanë fonde të kufizuara për këto lloje metodash të mbrojtjes.

### **4.3 Cilësia e mjedisit dhe ndikimet ekzistuese**

Përmbledhja e mëposhtme përfshijë kushtet ekzistuese dhe ndikimet mjedisore. Këto kushte janë vlerësuar duke përfshirë cilësinë e ajrit, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, përdorimi i tokës, peisazhi (errozioni, zjarri, ndotja) zhurmat, infrastrukturën, cilësia e jetës në bazë të mundësive të punësimit, zhvillimi ekonomik.

#### **Cilësia e ajrit :**

Cilësia e ajrit në zonën naftë-mbajtëse Patos-Maeinëz ndikohet shumë nga operacionet industriale dhe në këtë kohë cilësia e ajrit mund të përshkruhet si e varfër. BPAL kryen monitorimin e cilësisë së ajrit në një numër të vendeve të vendosura në të gjithë zonën e PM në mënyrë që të kapi një grup të dhënash të përgjithshme për zonën përfshirë këtu edhe objektin qëndror të trajtimit. Monitorimi i ajrit që është kryer përfshin burimet e emëtimit në ajër të përzgjedhura dhe të maten kundrejt normave të lejuara të cilat përfshijnë operacionet e BPAL.

Cilësia e ajrit në Bllokun F mund të jetë më e mirë në cilësi se ajo nuk ka të lokalizuar zhvillim industrie të rëndë dhe sheshi F53a është i vendosur në kodrat e larta.

#### **Cilësia e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore:**

Kushtet e ujrave nëntokësore në fushën e Patos-Marinëz janë ndikuar historikisht nga praktikat e dobëta operacionale dhe nga operatorët që kanë vepruar më parë në vënd. Megjithatë mundësitë e rendimentit të ujit të pijshëm apo të arsyeshëm nga depozitimet aluvionale të cekëta në këtë rajon është shumë e vështirë. Testet e përshkueshmërisë kanë konfirmuar se depozitat gjeologjike deri në 10 m thellësi kanë një përshkueshmëri relativisht të vogël dhe për këtë arsye janë konsideruar me shumë vështirësi që

depozitat aluviale që janë depozituar në shesh do të jenë në gjendje që të mbështesin çdo abstraksion kuptimplotë nëntokësor.

Ujrat nëntokësor dhe ato sipërfaqësor përreth sheshit F53a nuk janë ndikuar nga zhvillimi i hidrokarbureve. Ashtu si nuk ka çlirim apo dalje të ujit në sipërfaqe, në këtë mënyrë nuk ka asnjë ndikim në ujat nëntokësor dhe ato sipërfaqësor të lidhura me këtë shesh.

**Zhurmat :**

Zhurmat janë të lidhura me një operacion industrial. Kamionë dhe pajisje të tjera të punës janë pajisjet që rezultojnë që bëjnë zhurmë në zonë industrialempor këto pajisje nuk i kalojnë kriteret e zhurmës. Pajisjet veprojnë sipas kushteve specifike të prodhimit dhe duke përmbushur kërkesat e BPAL, deri në 70 dB.

**Shfrytëzimi i tokës :**

Toka në fushë-naftë Patos-Marinëz është ndikuar rëndë historikisht nga operacionet e prodhimit të naftës dhe të gazit nga kompanitë shtetërore. BPAL ka zhvilluar programe të gjera të rehabilitimit të tokës për ndotjen që në burim duke rezultuar kështu në një rënie të konsiderueshme të sasisë së hidrokarbureve të pranishme në tokë, në terren dhe në ujrat sipërfaqësore.

Tokat produktive bujqësore kërkojnë plehërim dhe ujitje duke rezultuar në rreth 50 % e tokave bujqësore të caktuara për tu braktisur. Praktika bujqësore intensive ka çuar edhe në erozion të tokës dhe të degardimit të kapacitetit të tokave.

**Peisazhi :**

Toka në rajonin rreth Patos-Marinëz konsiderohet të ketë intensitet të lartë bujqësor. Biodiversiteti është ndryshuar rëndë për shkak të ndërhyrjes njerëzore. Kodrat përreth qyteteve të Patosit dhe të Ballshit janë pjesërisht të mbuluara me bimësi natyrore për shkak të pemëve dhe të vreshtave me ullishte dhe shpullëzimi i specieve vëndase. Prerja intensive e pemëve dhe shpullëzimi janë kryer për të rritur sasinë e tokës bujqësore që rezulton në vetëm disa bashkësi të fragmetuara me bimësi natyrore.

**Infrastruktura :**

Infrastruktura si rrugët, energjia, shpërndarja e ujit dhe grumbullimi i ujrave të zeza / mbledhja e mbetjev është përgjegjësi e qeverisë shqipëtare, jo e BPAL. Aktivitetet në fushën e naftës kanë rezultuar në dëmtim të sipërfaqes rrugore dhe në gjenerim të pluhurit, por BPAL ka riparuar ose ka zëvendësuar rrugët e prekura. BPAL ka një departament aktiv të Marrëdhënieve me Komunitetin e cila ka rritur punësimin lokal, duke mbështetur aktivitetet e komunave kur kërkohet nga komunat lokale.

**Social-ekonomike :**

Popullsia e këtyre komunave është e mbështetur në vetë-punësim në sektorin e bujqësisë, biznesit të vogël dhe të punësimit në sektorin privat apo publik. Industria e naftës në zonë ka dhënë kontributin e asaj gjatë viteve. Industria ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1957 dhe që atëherë ajo ka punësuar shumë banorë të zonës ku shumica e tyre ishin punonjës të nivelit ulët apo të mesëm. Ata vazhduan jetën e tyre në fshatra, si pjesë e sektorit të naftës dhe të bujqësisë. Ky kombinim ka ofruar diversitet në të ardhurat e këtyre familjeve.

## 5 Kushtet Sociale

Ka katër fshatra brenda zonës së shpimit të psueve të Bllokut F. Keto fashtra përfshijnë Kreshpan, Lalar, Visok dhe Kasnicë. Informacioni në dispozicion nga burimet qeveritare është i kufizuar për komunat dhe informacioni kontradiktor ka të bëjë me fshatrat e vecanta, si i tillë është informacioni i mëposhtëm i siguruar për dy fshatrat më të mëdha Lalar dhe Kreshpan.

### Fshati Lalar

Lalar ishte pjesë e Komunës Portëz deri në zgjedhjet e qeverisjes vendore në 2015 kur ajo është ndryshuar për Bashkinë e Fierit. Rreth 1057 banorë nga të cilët 502 janë femra dhe jetojnë në fshatin Lalar.

### Fsahti Kreshpan

Kreshpani është një fshat në qarkun e Fierit, është i vendosur 13 km në jug-lindje të qytetit të Fierit. Ajo ishte pjesë e komunës Cakran deri në 2015 kur më vonë u bë pjesë e bashkisë së Fierit. Në Censusin e 2011 për Komunën Cakran popullsia ishte 11722, prej të cilëve 5675 ishin femra.

### 5.1 Qëndrat e banuara

Zona e projektit ndodhet në kodrat midis fshatrave Lalar dhe Kreshpan. Zona e propozuar është në kodrat ku ka disa shtëpi dhe veprimtari të vogla bujqësore. Edhe pse ky vend nuk duket të ketë banorë që jetojnë aty pranë, zona përshkohet me rrugë.

Banorët në të dy këto fshatra janë kryesisht të vetëpunësuar në bujqësi, apo në biznese të vogla të tilla si bar-kafene të vogla apo restorante të vogla. Disa mund të jenë të punësuar në stafin e njërive administrative (ish-komunat) apo dhe në kompani të tjera private. Shumica e të ardhurave të familjeve është duke punuar tokën dhe me prodhimet që nxjerrin. Shkalla e migrimit është e lartë dhe shumë meshkuj dhe femra kanë emigruar në Itali apo Greqi për të dërguar të ardhura në shtëpitë e tyre ku janë prindërit. Situata ka ndryshuar vitet e fundit, për shkak të krizës ekonomike të dyja këto vende të cilat kanë detyruar shqipëtarët të kthehen në shtëpi dhe të përpiqen që të sigurojnë jetesën këtu. Megjithatë papunësia është e lartë dhe njerëzit në zonë e përmendin atë si problemin kryesor të komunitetit.

Shërbimet e arsimit dhe të shëndetit nuk janë zhvilluar shumë mirë në të dy fshatrat. Në Lalar dhe në Kreshpan është një shkollë që edukon fëmijët vetëm deri në klasën e nëntë. Fëmijët më të rritur duhet të lëvizin për të vazhduar shkollën e mesme në fshatrat e jere përreth. Shërbimet shëndetësore janë të përkohshme dhe kanë shërbime të kufizuara. Spitali më i afërt është Spitali Rajonal i Fierit.

Infrastruktura ka rezultuar në zhvillimin e banimit përgjatë rrugës kryesore federale, si dhe rrugët më të vogla lokale. Shtëpitë tipike të banimit kanë një ngastër toke bujqësore ku të rrisin perimet dhe ndoshta një ose dy kafshë shtëpiake. Infrastruktura rrugore nuk është e mirë në fshat, rrugët janë të ngushta dhe të pasfaltuara, por rrugët që lidhin në fshat janë të shtruara. Banorët e fshatrave mund të udhëtojnë për të marrë produktin e tyre bujqësor në tregun e Fierit, por gjithsesi ka sisteme të kufizuara të shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë.

Nuk ka një sistem të organizuar të menaxhimit të mbeturinave në këto fshatra të vogla. Mbeturinat familjare jnaë të predispozura që të hidhen në toka të papërdorura ose në lumenj. Lumenjtë gjithashtu janë edhe një metodë zgjidhjeje për mbeturinat septike.

## 5.2 Marrëdhëniet midis komunitetit dhe Investitorëve

Në vijim është një përmbledhje e konsultimit me publikun, projektet e investimeve të komunitetit, monitorimin dhe vlerësimin, qendra e informacionit dhe e ankesave adresuar mekanizmit që është zhvilluar nga BPAL në zonën e Patos-Marinëz. Meqë Bllok F është një zonë e re eksplorimi, këto projekte të marrëdhënieve me komunitetin nuk janë zhvilluar.

Konsultimi me publikun që në vitin 2013.

- Informacioni mbi Operacionin B14 të fshatit Kallm i Madh;
- Zbulimi i informacionit të Projektit Sizmik 3D dhe Dëgjesa me Publikun;
- 15 grupe të fokusuar për të bërë takime në Marinëz, Zharrza, Sheqishtë, Kallm i Madh dhe Belinë me burrat, gratë apo dhe me të rinjtë e zones – Zbulimi i Rezultateve të konsultimit me banorët e fshatit.
- Monitorimi i ajrit dhe zbulimi i sistemit të mbledhjes ;
- Informacioni i projektit të ujitjes në Belinë;
- Blloku F në Seman;
- Zbulimi i ERP dhe konsultimi lidhur me pusët e lagësht 5259 dhe B14;
- Mbledhja dhe zbulimi i sistemit të informacionit në Patos-Marinëz;
- Planet e përgjithshme lokale.
- Studimi i familjeve në 5 fshatrat kryesore, Marinëz, Zharrza, Sheqishta, Kallm i Madh dhe Belinë;
- Informacioni i projektit për qëranë M3-S;
- Zbutja e pluhurit në Kallm i Madh;
- Projekti i rrugës Kallm i Madh;
- Kthimi i zhvendosjes së përkohshme në Marinëz;
- Informacioni për pusët e gazit;
- Informacioni mbi zbulimin e gazit në fshatin Belinë;
- Evakuimi i fshatit Verri;

Investimet e komunitetit që në vitin 2013

- Projekti i bujqësisë.
- Projekti i Ujitjes në fshatrat Belinë & Kallm i Madh;
- Trotualet në Belinë;
- Vija e ujit në Belinë;
- Fillimi i trajnimit të biznesit;
- Këshillim karriere;
- Projekti i kullimit;
- Parqe dhe gjelbërimi në Fier;
- Park dhe dhoma që luajnë fëmijët në Spiatlin Pedriatik në Fier;
- Faza e II e Spiatlit Pedriatik në Fier;
- Klube Anglishteje ;
- Program trajnimi në anglisht;
- Projekti i ujitjes në Jagodina & Kallm i Vogel;
- Klinikë shëndetësore në Jagodina;
- Klinikë shëndetësore në Kallm i Madh;
- Shesh lojërash në fshatin Kallm i Vogel;
- Rrugët bujqësore në Kuman;
- Rruga e hyrjes në Lalar;



